

URDHËR
Nr. 178, datë 30.12.2025

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR PËRMIRËSIMIN E RENDITJES
SË SHQIPËRISË NË INDEKSIN E OECD-SË PËR POLITIKAT E NMV-VE.**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të VKM Nr. 621, datë 10.10.2024 “Për miratimin e dokumentit të politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027”, në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian “Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Planit të Veprimit për Përmirësimin e Renditjes së Shqipërisë në Indeksin e OECD-së për Politikat e NMV-ve (Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme), bazuar në rekomandimet e Raportit për Shqipërinë në raportin e vitit 2022: “Indeksi i Politikave për NVM-të në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Politikave të Nxitjes së Biznesit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit për zbatimin e urdhrit dhe monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË DHE INOVACIONIT
Delina Ibrahimaj

DHJETOR 2025



**PLANI I VEPRIMIT PËR PËRMIRËSIMIN E
RENDITJES SË SHQIPËRISË NË INDEKSIN E
OECD-SË PËR POLITIKAT E NMV-VE
2026-2027**

MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT

Përmbajtja

PLANI I VEPRIMIT PËR PËRMIRËSIMIN E RENDITJES SË SHQIPËRISË NË INDEKSIN E OECD-SË PËR POLITIKAT E NMV-VE

2026-2027

Hyrje

Lidhja me strategjitë kombëtare dhe dokumentat politikë

Metodologjia

Monitorimi

Grupi i Punës përgjegjës për hartimin e Planit të Veprimit

Institucionet Përgjegjëse për masat në Planin e Veprimit

Plani i Veprimit

Dimensioni 1 – Të mësuarit rreth sipërmarrjes dhe sipërmarrja e grave

Dimensioni 2 – Falimenti dhe mundësitë e dyta

Dimensioni 3 – Kuadri institucional dhe rregullator për politikëbërjen e NVM-ve

Dimensioni 4 – Mjedisi operacional i NVM-ve

Dimensioni 5a – Shërbimet mbështetëse për SME-të

Dimensioni 5b – Prokurimi publik

Dimensioni 6 – Aksesimi në financë

Dimensioni 7 – Standardet dhe rregulloret teknike

Dimensioni 8a – Aftësitë e sipërmarrjes

Dimensioni 8b – Politikat e inovacionit

Dimensioni 9 – SME-të në një ekonomi të gjelbër

Dimensioni 10 – Ndërkombëtarizimi i SME-ve

Dimensioni 11: Transformimi Digjital i NMV-ve

PLANI I VEPRIMIT PËR PËRMIRËSIMIN E RENDITJES SË SHQIPËRISË NË INDEKSIN E OECD-SË PËR POLITIKAT E NMV-VE

2026-2027

Hyrje

Plani i Veprimit për përmirësimin e renditjes së Shqipërisë në Indeksin e OECD për Politikën e NMV-ve përfaqëson dokumentin udhëzues kryesor institucional që orienton ndërhyrjet prioritare të administratës publike për periudhën 2025–2027, me synim rritjen e performancës së politikave kombëtare për NMV-të dhe përshpejtimin e përafrimit me standardet e Bashkimit Europian. Ky Plan është hartuar në vijimësi të punës paraprake analitike dhe orientuese të kryer me *Brief Paper* dhe *Policy Orientation Paper*, të cilat shërbyen si bazë themelore për vlerësimin e situatës aktuale dhe përcaktimin e fushave prioritare të ndërhyrjes.

Brief Paper – Raporti OECD SME Policy Index përmbledh gjetjet kryesore të raportit të OECD-së për vitin 2022, duke ofruar një analizë të shkurtër të performancës së Shqipërisë në secilin nga 10 dimensionet e vlerësimit, si dhe rekomandimet konkrete për përmirësimin e tyre. Dokumenti evidenton fushat ku Shqipëria ka shënuar progres – përfshirë dixhitalizimin e shërbimeve publike, përmirësimin e mjedisit operacional, avancimin në prokurimin publik dhe nxitjen e ndërkombëtarizimit – si dhe zonat ku kërkohen ndërhyrje të menjëhershme, si inovacioni, aksesimi i financave, aftësitë e NMV-ve, ekonomia e gjelbër dhe harmonizimi i mëtejshëm me standardet europiane. Brief Paper identifikon gjithashtu nevojën për forcimin e instrumenteve të politikëbërjes, reduktimin e barrës administrative dhe rritjen e instrumenteve të mbështetjes, duke kërkuar masa të qarta institucionale dhe të matshme për të siguruar përmirësim të renditjes në raportin e ardhshëm.

Ndërkohë, **Policy Orientation Paper** paraqet një kornizë të detajuar orientuese për hartimin e Planit të Veprimit, duke përfshirë analizën e dobësive të identifikuara nga OECD, rekomandimet tematike dhe qasjen e re metodologjike të indeksit. Ky dokument përcakton elementet që duhet të përmbajë Plani i Veprimit, përfshirë: përcaktimin e masave të nevojshme të ndarë sipas dimensioneve, identifikimin e institucioneve përgjegjëse, hartimin e objektivave të matshme, definimin e indikatorëve të performancës, vendosjen e afateve kohore, si dhe ndërtimin e mekanizmave të qëndrueshëm të monitorimit dhe raportimit. Gjithashtu, Policy Orientation Paper thekson rëndësinë e harmonizimit të ndërhyrjeve të Planit të Veprimit me Strategjinë e re të NMV-ve 2026–2030 dhe me praktikën më të mira të vendeve europiane, duke siguruar koherencë dhe kontinuitet politikash.

Në këtë kontekst, Plani i Veprimit synon të ofrojë një qasje të integruar dhe të bazuar në evidencë për të përshpejtuar transformimin e ekosistemit të NMV-ve në Shqipëri. Çdo masë e propozuar është lidhur drejtpërdrejt me rekomandimet specifike të OECD-së, duke reflektuar qartësisht nevojat për ndërhyrje në nivel rregullator, institucional, dixhital, financiar dhe zhvillimor. Plani merr në konsideratë rezultatet e dobëta të identifikuara në indeks dhe i adreson ato përmes ndërhyrjeve të synuara që përfshijnë arsimin sipërmarrës, sipërmarrjen e grave, përmirësimin e procedurave të falimentimit, forcimin e politikëbërjes, rritjen e aksesit në financë, nxitjen e

inovacionit, tranzicionin e gjelbër, përkrahjen e aftësive, transformimin dixhital dhe ndërkombëtarizimin e NVM-ve.

Hartimi i këtij Plani përfaqëson një angazhim institucional për të garantuar zbatim më efikas të politikave të NVM-ve dhe rritjen e konkurrueshmërisë së tyre në tregun vendas dhe atë ndërkombëtar. Dokumenti siguron bazën për koordinim të qëndrueshëm ndërinstitucional, përmirësim të cilësisë së legjislacionit dhe procesit rregullator, si dhe për ndërtimin e një sistemi efektiv monitorimi dhe vlerësimi, në përputhje me metodologjinë e përditësuar të OECD-së. Zbatimi i Planit të Veprimit pritet të kontribuojë në përmirësimin e dukshëm të renditjes së Shqipërisë në raportin e ardhshëm të OECD SME Policy Index dhe në përparimin e mëtejshëm të vendit në procesin e integritit evropian.

Lidhja me strategjitë kombëtare dhe dokumentat politikë

Plani i Veprimit për përmirësimin e renditjes së Shqipërisë në Indeksin e OECD-së për politikat e SME-ve është pjesë integrale e një arkitekture më të gjerë strategjike që po udhëheq transformimin ekonomik të vendit. Së pari, ai harmonizohet me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030 (SKZHIE), e cila e identifikon rritjen e produktivitetit, forcimin e konkurrueshmërisë së sektorit privat dhe modernizimin e institucioneve si kushte të nevojshme për integrimin në BE. Përmirësimi i indikatorëve të OECD-së shërben si mekanizëm konkret monitorimi për këto objektiva, duke fuqizuar llogaridhënien institucionale dhe eficiencën e politikave publike që ndikojnë në zhvillimin e Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme.

Në të njëjtën linjë, plani lidhet drejtpërdrejt me Strategjinë për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve 2021–2027, e cila vendos SME-të në qendër të politikave të zhvillimit të sipërmarrjes, përfshirë digjitalizimin, ndërkombëtarizimin, përmirësimin e klimës së biznesit, dhe rritjen e kapaciteteve menaxheriale. Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve (BIDS 2021-2027) është një nga strategjitë kryesore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit që mbështet sektorin privat dhe orienon politikat për rritjen ekonomike të vendit. Në vitin 2025, strategjia BIDS 2021–2027 u rishikua dhe vizioni i saj u përditësua për t'u përshtatur me procesin dhe objektivat në kuadër të integritit evropian. Vizioni i ri synon një ekonomi shqiptare konkurruese, më të orientuar drejt inovacionit dhe të bazuar në njohuri, të integruar në Bashkimin Evropian dhe rajon, që krijon vende pune të reja e cilësore për gratë dhe burrat, duke shfrytëzuar potencialet e tranzicionit digjital dhe të gjelbër si dhe transformimet e zinxhirit ndërkombëtar të vlerës, duke theksuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe të barabartë. Masat e parashikuara në planin e veprimit — si përmirësimi i shërbimeve publike për biznesin, rritja e aksesit në financa, forcimi i infrastrukturës së inovacionit dhe lehtësimi i procedurave administrative — janë plotësisht të sinkronizuara me çka parashikon kjo strategji.

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit është institucioni lider në ndjekjen dhe zbatimin e Kapitullit 20 “Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale” i cili është i fokusuar në konkurrencën dhe rritjen gjithëpërfshirëse në strukturën e negociatave të Shqipërisë për integrimin në Bashkimin Evropian. Në kuadër të detyrimeve që i kanë lindur Shqipërisë për piketat mbyllëse të këtij kapitulli, do të hartohet dhe miratohet një dokument politik për NMV-të 2026-2030, i cili do të jetë në linjë me objektivin dhe masat e parashikuara në planin e veprimit për përmirësimin e renditjes së vendit tonë në indeksin e OECD-së për NMV-të.

Një shtyllë e rëndësishme e politikave të zhvillimit është Strategjia e Specializimit Inteligent (S3) 2025-2030, e cila synon të orientojë Shqipërinë drejt sektorëve me potencial të lartë inovativ dhe eksportues. S3 jo vetëm identifikon prioritetet teknologjike dhe industriale ku vendi mund të ndërtojë avantazh konkurrues (si agro-përpunimi, turizmi i qëndrueshëm, teknologjitë dixhitale, energjitë e gjelbra), por edhe thekson rolin qendror të SME-ve si bartëse të proceseve të transformimit teknologjik. Përputhshmëria me Indeksin e OECD-së ndihmon në forcimin e ekosistemit të inovacionit që S3 kërkon të ndërtojë — përmes praktikave më të mira, financimit të inovacionit, rritjes së kapaciteteve dhe mbështetjes së ndërmarrjeve të reja novatore.

Për më tepër, plani lidhet në mënyrë organike me proceset kombëtare të reformave në kuadër të Integrimit Evropian, duke u mbështetur te parimet e Small Business Act for Europe (SBA) dhe te prioritetet e *acquis communautaire* në fushën e konkurrencës, prokurimeve publike, ndihmës shtetërore, politikave industriale dhe digjitalizimit. Këto reforma janë të domosdoshme jo vetëm për afrimin me standardet e BE-së, por edhe për rritjen e vlerësimit të Shqipërisë në Indeksin e OECD-së, i cili në thelb është një instrument matës i pjekurisë institucionale dhe efektivitetit të politikave publike për SME-të.

Në këtë kuadër, plani i veprimit nuk është thjesht një dokument teknik, por një mekanizëm kohezioni midis strategjive kombëtare, duke shërbyer si ura lidhëse midis objektivave afatgjata të zhvillimit, prioritetëve të reformave strukturore dhe kërkesave konkrete të vlerësimit ndërkombëtar. Ai siguron që politikat për SME-të të mos trajtohen si masa të fragmentuara, por si pjesë e një vizioni të unifikuar ekonomik që synon transformim produktiv, rritje të qëndrueshme dhe të përshpejtuar në procesin e integrimit evropian të Shqipërisë.

Metodologjia

Metodologjia e hartimit të Planit të Veprimit është bazuar në një proces të strukturuar dhe analitik, në përputhje me qasjen e përditësuar të OECD SME Policy Index, i cili vlerëson politikat sipas dimensioneve dhe nën-dimensioneve tematikë. Procesi ka përfshirë shqyrtimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të raportit të OECD 2022, analizën e dobësive të identifikuara në dokumentet paraprake Brief Paper dhe Policy Orientation Paper, si dhe vlerësimin e programeve dhe politikave ekzistuese në nivel kombëtar. Për secilin dimension janë përcaktuar masat prioritare duke u udhëhequr nga parimi i relevancës së ndikimit dhe nevojës për ndërhyrje të menjëhershme ose afatmesme. Çdo masë është formuluar duke përcaktuar qëllimin kryesor, institucionin përgjegjës dhe afatin orientues të zbatimit, si dhe përshkrimin përmbledhës të veprimeve që do të ndërmerren. Progresi në zbatimin e masave do të ndiqet përmes raportimit vjetor nga institucionet përgjegjëse tek Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, e cila do të përmbledhë ecurinë e përgjithshme të Planit. Kjo qasje siguron koherencë të ndërhyrjeve dhe mundëson ndjekjen e rregullt të progresit në përmirësimin e mjedisit të politikëbërjes për NVM-të.

Monitorimi

Monitorimi i zbatimit të Planit të Veprimit do të kryhet nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI), e cila ka rolin e institucionit përgjegjës për ndjekjen e ecurisë së masave të parashikuara. Çdo institucion përgjegjës për zbatimin e masave do të raportojë **një herë në vit** tek MEI mbi statusin e realizimit të tyre, duke përshkruar shkurtimisht hapat e ndërmarrë dhe nivelin e përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në Plan. Në bazë të këtyre raportimeve vjetore, MEI do

të përmbledhë situatën e përgjithshme të zbatimit të Planit të Veprimit dhe, nëse është e nevojshme, do të propozojë masa shtesë ose rishikime të caktuara për të siguruar vijimësinë dhe efektivitetin e ndërhyrjeve në mbështetje të NVM-ve.

Grupi i Punës përgjegjës për hartimin e Planit të Veprimit

Bazuar në VKM Nr. 621, datë 10.10.2024 “Për miratimin e dokumentit të politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027”, në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian “Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor”, lidhur me reformën 1.1.4, Hapi 5 - Miratimi i një plani veprimi për përmirësimin e renditjes së Shqipërisë në Indeksin e OECD-së për politikën e SME-ve, është ngritur grupi i punës ndërinstitutional për hartimin e Planit të Veprimit, nëpërmjet Urdhrit të ish Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 258, datë 26.02.2025, për “Krijimin e Grupit të Punës për Hartimin e Planit të Veprimit për Përmirësimin e Renditjes së Shqipërisë në Indeksin e Politikave për NVM-të të OECD-së”.

Janë zhvilluar 5 takime fizike dhe disa takime online përgjatë vitit me anëtarët e grupit të punës.

Paralelisht punës për hartimin e Planit të Veprimit me përfaqësuesit e grupit të punës ngritur me Urdhër Minisri, vijoi puna për hartimin e Urdhërit të KM i cili u miratua në Nëntor 2025 bazuar në Urdhërin e Kryeministrit nr. 211, datë 10.11.2025. Dokumenti i Planit të Veprimit është hartuar nga secili anëtar i grupit të punës, sipas fushës së përgjegjësisë institucionale. Ky proces është udhëhequr dhe koordinuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit.

Në nëntor 2025 janë zhvilluar disa takime teknike për detajimin e masave sipas rekomandimeve të OECD, insitucioneve përgjegjëse dhe afateve, me përfaqësuesit e grupit të punës për finalizimin e masave që do të përfshihen në Planin e Veprimit.

Institucionet Përgjegjëse për masat në Planin e Veprimit

Dimensioni 1 “Të mësuarit sipërmarrës dhe sipërmarrja e grave”: Ministria e Arsimit; Banka e Shqipërisë; Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit; Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar; Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve;; Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive.

Dimensioni 2 “Falimentimi dhe shansi i dytë”: Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia e Falimentit.

Dimensioni 3 “Kuadri institucional dhe rregullator për politikëbërjen e NVM”: Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit; Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;

Dimensioni 4 “Mjedisi operacional për NVM-të”: Ministria e Financave, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

Dimensioni 5a “Shërbimet mbështetëse për NVM-të”: Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit; Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve.

Dimensioni 5b “Prokurimi Publik” ka rekomandime të realizuara nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Dimensioni 6 “Aksesi në financë për NVM”: Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit; Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ; Banka e Shqipërisë; Ministria e Financave.

Dimensioni 7 “Standardet dhe rregulloret teknike”: Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Inspektorati Shtetëror i Mbikqyrjes së Tregut; Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë; Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit; Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit.

Dimensioni 8a “Aftësitë e sipërmarrjes”: Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia Kombëtare për Aftësimin Formimin, Profesional dhe Kualifikimet; Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive.

Dimensioni 8b “Politikat e inovacionit për NVM-të”: Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit; Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve; Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Dimensioni 9 “NVM-të në një ekonomi të gjelbër”: Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit; Banka e Shqipërisë; Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit;

Dimensioni 10 “Ndërkombëtarizimi i NVM-ve” : Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit; Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve; Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Dimensioni 11 “Transformimi digjital i NVM-ve” është dimension i ri dhe nuk ka rekomandime nga OECD-ja, por janë parashikuar disa masa me institucionet përgjegjëse që janë: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Autoriteti Kombëtar i Sigurisë Kibernetike; Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

Afatet e masave të parashikuara: 2026-2027

Plani i Veprimit

Indeksi i OECD-së për Politikën e NMV-ve ofron një vlerësim gjithëpërfshirës të mjedisit të politikëbërjes për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Shqipëri, duke analizuar dhjetë dimensionet kyçe që shtrihen nga edukimi sipërmarrës dhe sipërmarrja e grave, të falimentit, mjedisi operacional, inovacioni dhe ndërkombëtarizimi.

Rekomandimet e OECD-së theksojnë modernizimin institucional, digjitalizimin e shërbimeve, forcimin e kapaciteteve administrative, zgjerimin e instrumenteve financiare, nxitjen e inovacionit, tranzicionin e gjelbër dhe rritjen e konkurrueshmërisë ndërkombëtare.

Rezultatet tregojnë se Shqipëria ka shënuar progres në të gjitha dimensionet: nga rishikimi i kurrikulave dhe mbështetja e sipërmarrjes së grave, të vendosja e mekanizmave të paralajmërimit të hershëm në faliment, përmirësimi i kuadrit rregullator, digjitalizimi i procedurave tatimore, fuqizimi i shërbimeve mbështetëse të AIDA-s, avancimet në prokurimin publik, rritja e aksesit në financë dhe krijimi i instrumenteve të reja për inovacion. Po ashtu janë hedhur hapat drejt zbatimit të standardeve ndërkombëtare, forcimit të aftësive sektoriale, zhvillimit të politikave të gjelbërimit dhe nxitjes së eksporteve përmes platformave digjitale dhe programeve të dedikuara. Ky progres reflekton angazhimin institucional të qëndrueshëm, por kërkon vazhdimësi dhe thellim të reformave për t’u përfunduar plotësisht me praktikën më të mira evropiane.

Dimensioni 1 – Të mësuarit rreth sipërmarrjes dhe sipërmarrja e grave

Rekomandime : OECD rekomandon forcimin e partneriteteve kombëtare për edukimin sipërmarrës, harmonizimin me kornizën evropiane EntreComp dhe rritjen e mbështetjes për sipërmarrjen e grave.

1. Forcimi i koordinimit kombëtar për mësimin sipërmarrës dhe sipërmarrjen e grave

- Krijimi i një partneriteti kombëtar ose caktimi i një organi shumëpalësh që të marrë drejtimin për koordinimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e:
 - (1) mësimin sipërmarrës në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit;
 - (2) nismave për zhvillimin e **sipërmarrjes së grave**.
- Për mësimin sipërmarrës, konsiderimi i përfshirjes së këtij dimension si temë specifike brenda partneriteteve që mbështesin **Strategjinë Kombëtare të Arsimit (2021–2026)**, ose brenda një grupi tematik të lidhur me **Grupin Ndërmnistror të Menaxhimit të Politikave të Integruara**.
- Për sipërmarrjen e grave, sigurimi i një përfaqësim të plotë të organizatave me fokus gjinor në një grup pune qeveritar ekzistues—si **Grupi i Integruar i Menaxhimit të Politikave** (ose një grup tematik i lidhur me të)—ose krijimi i një strukture shtesë bashkëpunimi që përfshin si aktorë qeveritarë ashtu edhe joqeveritarë.

2. Rritja e kapaciteteve të mësuesve për kompetencat sipërmarrëse

- Dhënia prioritet harmonizimit të programeve të formimit të mësuesve universitarë me përmbajtjen bashkëkohore të trajnimit që nxit ndërgjegjësimin, kuptimin dhe aftësinë e mësuesve për të integruar kompetencat kyçe të sipërmarrjes në proceset mësimore.
- Sigurimi që këto programe të mbështeten dhe të jenë në përputhje të plotë me kornizën evropiane **EntreComp**¹.

3. Hartimi i udhëzimeve kombëtare për integrimin e kompetencave sipërmarrëse

- Hartimi i udhëzimeve kombëtare për mësuesit që shpjegojnë mënyrat e integrimit të zhvillimit të sipërmarrjes si kompetencë kyçe ndërkurrikulare në të gjitha fushat e kurrikulës.
- Sigurimi që këto udhëzime:
 - Të jenë të përputhshme me **EntreComp**;
 - Të aplikohen në të gjitha nivelet e arsimit të detyrueshëm;
 - Të mund të përfshihen si pjesë e udhëzimeve më të gjera për zhvillimin e kompetencave kyçe të mësuesve.

Rezultate : Statusi aktual tregon përparim përmes rishikimit të kurrikulave, programeve mbështetëse për gratë sipërmarrëse, zhvillimit të trajnimeve kombëtare për mësuesit dhe

¹ EntreComp (Entrepreneurship Competence Framework) është Korniza Evropiane e Kompetencave Sipërmarrëse, e zhvilluar nga Bashkimi Evropian (Joint Research Centre – JRC) për të përcaktuar aftësitë thelbësore që nxisin sipërmarrjen, kreativitetin, inovacionin dhe marrjen e iniciativës në çdo kontekst — jo vetëm në biznes.

publikimit të statistikave mbi pjesëmarrjen e grave në programet profesionale. Institucionet kanë ndërmarrë edhe nisma për partneritete me sektorin privat dhe inkubatorët.

Masa të planifikuara për përmirësimin e renditjes:

1. Mbështetja për programe pilot në universitete

Planifikohet zhvillimi i një sërë programesh pilot brenda universiteteve, me synim forcimin e lidhjes midis arsimit të lartë, aftësive të kërkuara në treg dhe sipërmarrjes. Këto programe do të përfshijnë module trajnimi për pedagogët dhe sipërmarrësit, si dhe komponentë praktikë që nxisin mësimin përmes përvojës. Qëllimi kryesor është të testohen modele të reja bashkëpunimi dhe të rritet roli i universiteteve në zhvillimin e aftësive të studentëve.

Institucioni përgjegjës : Ministria e Arsimit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit

Parauniversitar Afati : 2026 - 2027

2. Bashkëpunimi me donatorët dhe lidhja me EntreComp

Planifikohet harmonizimi i metodologjive dhe indikatorëve të raportimit me kornizën europiane EntreComp për aftësitë sipërmarrëse. Kjo do të mundësojë standardizim të qasjes, krahasueshmëri të rezultateve dhe forcim të bashkëpunimit me donatorët ndërkombëtarë në zhvillimin e programeve të aftësive dhe sipërmarrjes.

Institucioni përgjegjës : Ministria e Arsimit

Afati : 2026 - 2027

3. Krijimi i një rrjeti kontakti me donatorët për mbështetjen e kërkimit shkencor

Do të krijohet një rrjet komunikimi që lidh donatorët me projektet kërkimore të institucioneve vendase, duke synuar identifikimin e sinergjive sipas fushave të interesit. Një fokus i rëndësishëm i këtij rrjeti do të jetë fuqizimi i grave dhe vajzave në kërkim shkencor, përmes organizimit të workshop-eve dhe thirrjeve të hapura (Open MA Call) me tema prioritare në fushën e biznesit dhe akademisë.

Institucioni përgjegjës : Ministria e Arsimit

Afati : 2026 - 2027

4. Rishikimi i kurrikulave me fokus në praktikën

Planifikohet rishikimi dhe modernizimi i programeve mësimore për të shtuar peshën e aktiviteteve praktike në procesin e nxënies të cilat synojnë zhvillimin e aftësisë për të përdorur njohuritë dhe aftësitë për të marrë vendime të mirinformuara në çdo fushë të jetës, pra edhe në atë të sipërmarrjes. Po kështu, në arsimin parauniversitar do të rritet peshja e edukimit për karrierën duke filluar që në arsimin fillor me përshirjen e njohurive për profesionet dhe aftësitë që kërkohen për to.

Modeli “learning-by-doing”, do të zërë vend gjithnjë e më të madh në procesin e të mësuarit, duke forcuar lidhjen midis teorisë dhe praktikës.

Institucioni përgjegjës : Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar

Afati : 2026 - 2027

5. Trajnim kombëtar për mësuesit e arsimit profesional mbi modulën e sipërmarrjes

Do të organizohet një program kombëtar trajnimi për mësuesit e arsimit profesional, me qëllim rritjen e cilësisë së zbatimit të modulit të sipërmarrjes. Ky trajnim do të përqendrohet në metodologjitë moderne të mësimdhënies, integrimin e praktikave të biznesit dhe përdorimin e mjeteve interaktive.

Institucioni përgjegjës : Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit

Afati : 2026 - 2027

6. Workshop-e dhe Open Call për përfshirjen e vajzave dhe grave në kërkim

Do të organizohen workshop-e dhe thirrje të hapura për hartimin e projekteve kërkimore, duke e orientuar fokusin drejt rritjes së pjesëmarrjes së vajzave dhe grave në shkencë, inovacion dhe sipërmarrje akademike.

Institucioni përgjegjës : Ministria e Arsimit

Afati : 2026 - 2027

6. Anëtarësimi i Bankës së Shqipërisë në WE-FI Code

Parashikohet përfshirja në iniciativën ndërkombëtare WE-FI (Women Entrepreneur Finance Inclusion), e cila synon rritjen e aksesit të grave në financa, investime dhe mundësi sipërmarrjeje. Kjo do të sjellë mjete, fonde dhe praktika të mira ndërkombëtare për mbështetjen e grave sipërmarrëse.

Institucioni përgjegjës : Banka e Shqipërisë

Afati : 2026 - 2027

10. Publikimi i statistikave dhe rasteve të suksesit për gratë në trajnim dhe vetëpunësim

Do të përgatiten dhe publikohen raporte periodike mbi numrin e vajzave dhe grave të përfshira në trajnimet profesionale për aftësitë sipërmarrëse, si dhe shembujt e suksesit të grave të mbështetura nga programet e vetëpunësimit. Synimi është rritja e transparencës, promovimi i rezultateve pozitive dhe inkurajimi i pjesëmarrjes më të gjerë.

Institucioni përgjegjës : AKPA

Afati : 2026 - 2027

11. Rritja e vlerës së financimit për programin e vetëpunësimit

Planifikohet rritja e vlerës së financimit për programin e vetëpunësimit, me qëllim rritjen e mbulimit, ofrimin e granteve më të mëdha duke përfshirë më shumë gra dhe të rinj.

Institucioni përgjegjës : AKPA

Afati : 2026 - 2027

12. Nxitja e investimeve private në kërkim shkencor dhe inovacion

Synohet rritja e ndërgjegjësimit tek bizneset për rëndësinë e investimeve private në kërkim shkencor dhe fusha inovative. Do të ofrohen stimuj për kandidatët, përfshirë certifikata stazhi ose dëshmi pjesëmarrjeje në projekte kërkimore, për të rritur atraktivitetin e përfshirjes së tyre në iniciativa shkencore.

Institucioni përgjegjës : Ministria e Arsimit

Afati : 2026 - 2027

Dimensioni 2 – Falimenti dhe mundësitë e dyta

Rekomandimet kërkojnë vendosjen e sistemit të paralajmërimit të hershëm, modernizimin e procedurave të falimentimit dhe promovimin e një qasjeje që lejon sipërmarrësit e ndershëm të nisin nga e para.

Rezultate: Shqipëria ka avancuar me përgatitjen e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm, digjitalizimin e ankandeve dhe procedurave, përmirësimin e rregulloreve për riorganizimin jashtëgjyqësor dhe nisjen e fushatave të ndërgjegjësimit. Janë propozuar skema mbështetëse për bizneset në vështirësi dhe struktura ndër-institucionale për monitorim.

Masa të planifikuara për përmirësimin e renditjes:

1. Zbatimi i Sistemit Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm (Early Earning System)

Krijimi i një sistemi kombëtar që identifikon herët shenjat e vështirësive financiare synon të ulë numrin e falimentimeve përmes ndërhyrjeve të shpejta. Ky sistem është në përputhje me standardet e BE-së dhe rrit besueshmërinë e vendit në raport me Direktivën 2019/1023.

Institucioni përgjegjës : Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia e Falimentit

Afati : 2026 - 2027

2. Hartimi i udhëzuesve për menaxhimin e krizës financiare për NVM-të

Udhëzuesit do të shërbejnë si manuale praktike që u tregojnë bizneseve si të diagnostikojnë rreziqet financiare dhe si të ndërhyjnë për t'i adresuar ato. Masa forcon kapacitetet e brendshme të NVM-ve dhe rrit qëndrueshmërinë e tyre në treg.

Institucioni përgjegjës : Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia e Falimentit

Afati : 2026 - 2027

3. Krijimi i Qendrave të Këshillimit për Parandalimin e Falimentimit

Këto qendra ofrojnë shërbime profesionale të këshillimit financiar, juridik dhe organizativ. Ato pritet të shërbejnë si pika ndërhyrjeje të hershme, duke ulur barrën e sistemit gjyqësor dhe duke reduktuar falimentimet e panevojshme.

Institucioni përgjegjës : Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia e Falimentit

Afati : 2026 - 2027

4. Fushatë kombëtare për ndërgjegjësim financiar

Fushata synon rritjen e kulturës financiare në biznes dhe shoqëri përmes informimit mbi menaxhimin e borxheve dhe parandalimin e riskut financiar. Ndikon direkt në zvogëlimin e borxheve të këqija dhe sjell sjellje më të përgjegjshme financiare.

Institucioni përgjegjës : Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Banka e Shqipërisë; Agjencia e Falimentit

Afati : 2026 - 2027

5. Digjitalizimi i procesit të falimentimit

Përfshin ankandet elektronike. Masë që rrit transparencën, shpejtësinë dhe ul korrupsionin potencial në procedurat e falimentimit.

Institucioni përgjegjës : Agjencia e Falimentit,

QKB, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Afati : 2026 - 2027

7. Rishikimi i rregullores për marrëveshjet jashtëgjyqësore

Kjo masë lejon riorganizimin e bizneseve në vështirësi pa kaluar domosdoshmërisht përmes gjykatës. Ul ngarkesën gjyqësore dhe u jep NVM-ve një rrugë më të lehtë për rimëkëmbje.

Institucioni përgjegjës : Agjencia e Falimentit

Afati : 2026 - 2027

9. Përmirësimi i kuadrit ligjor për falimentimin personal

Reduktimi i periudhës së fshirjes së borxhit në 3 vite për forcimin e mekanizmit të "shansit të dytë". Nxiti sipërmarrësit të rihapen në treg dhe ul stigmatizimin e falimentimit.

Institucioni përgjegjës : Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia e Falimentit

Afati : 2026 - 2027

11. Fushata “Një shans i dytë për sipërmarrësit e ndershëm”

Rrit ndërgjegjësimin publik për falimentimin si proces normal ekonomik dhe ul stigmatizimin. Mbron sipërmarrësit nga paragjykimet dhe inkurajon rikthimin e tyre në treg.

Institucioni përgjegjës : Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia e Falimentit

Afati : 2026 - 2027

12. Programi i rikthimit në treg (Re-entry Programme)

Ofron trajnime, mentorim dhe mbështetje për sipërmarrësit që kanë kaluar një proces falimentimi. Ndihmon në rritjen e shkallës së mbijetesës së bizneseve të reja dhe përmirëson klimën e sipërmarrjes.

Institucioni përgjegjës : Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia e Falimentit

Afati : 2026 - 2027

13. Krijimi i Komitetit Ndërinstitucional për Falimentimin

Ky komitet koordinon institucionet kryesore për zbatimin efektiv të reformave. Siguron harmonizimin e politikave dhe shmang mbivendosjet institucionale.

Institucioni përgjegjës : Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia e Falimentit

Afati : 2026 - 2027

14. Hartimi i treguesve të performancës (KPI)

Përgatitja e indikatorëve matës lejon vlerësimin objektiv të impaktit të çdo mase dhe ndihmon në marrjen e vendimeve të bazuara në evidencë.

Institucioni përgjegjës : Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia e Falimentit

Afati : 2026 - 2027

15. Raportimi vjetor ndaj OECD dhe BE

Rrit llogaridhënien dhe transparencën ndërkombëtare. Ndihmon në përmirësimin e renditjes së vendit në raport me standardet evropiane dhe praktikën më të mira.

Institucioni përgjegjës : Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia e Falimentit

Afati : 2026 - 2027

Dimensioni 3 – Kuadri institucional dhe rregullator për politikëbërjen e NVM-ve

Rekomandime : OECD nënvizon nevojën për thjeshtim ligjor, reduktim të barrës administrative dhe forcim të analizës së ndikimit rregullator.

Rezultate: Institucionet shqiptare kanë ndërmarrë trajnime të administratës publike për respektimin e kornizave ligjore dhe standardeve të transparencës, duke përfshirë të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Ndër rekomandimet e lëna në kuadër të kuadrit institucional dhe rregullator për politikëbërjen e NVM-ve, është **promovimi i përdorimit të nënshkrimit elektronik nga NVM-të**. Promovimi i dobishmërisë së nënshkrimeve elektronike midis bizneseve duhet të ndihmojë në rritjen e përdorimit të tyre dhe të inkurajojë më shumë biznese të përdorin shërbimet dixhitale. Qeveria dhe AKSHI duhet të shikojnë gjithashtu uljen e kostove dhe barrierave teknologjike për miratimin e nënshkrimit elektronik (si p.sh. pajisjet e nevojshme). Kjo mund të bëhet duke adoptuar zgjidhje celulare, të tilla si nënshkrimi elektronik përmes celularit përmes teknologjisë cloud.

Për sa më lart, që nga viti 2020, AKSHI ka ndryshuar dhe përmirësuar teknologjinë me të cilën ofron shërbime të kualifikuara dhe të besuara, siç është edhe nënshkrimi elektronik. Konkretisht, është kaluar nga teknologjia e vjetër me USB në teknologjinë me nënshkrimin elektronik në remote nëpërmjet platformës së nënshkrimit elektronik, e cila është funksionale 24/7. Gjithashtu, ky shërbim është i integruar në 42 sisteme informatike, ku mund të përdoret pa pasur nevojë që përdoruesit të logohen më parë në platformën e nënshkrimit elektronik. Ky përmirësim i teknologjisë ka bërë që numri i nënshkrimeve elektronike për nëpunësit privatë të rritet nga 8,900 përpara vitit 2020 në 49,000 që janë aktualisht.

Zëvendësimi i teknologjisë ka mundësuar që të zvogëlohet kostoja e ofrimit të këtij shërbimi nga 6,400 lekë në vit që ofrohej më parë nëpërmjet pajisjes USB token në 4,800 lekë në vit nëpërmjet nënshkrimit elektronik remote. Gjithashtu, të gjithë nëpunësit e subjekteve private mund ta përdorin këtë shërbim nëpërmjet aplikacionit SQSign, të zhvilluar nga AKSHI dhe të disponueshëm në versionet iOS dhe Android.

Masa të planifikuara për përmirësimin e renditjes:

1. Trajnimi i administratës publike për respektimin e të drejtës së informimit dhe mbrojtjes së të dhënave

Kjo masë synon forcimin e kapaciteteve të administratës publike gjatë procesit të hartimit të akteve nënligjore dhe përcaktimit të kuadrit ligjor përkatës. Trajnimet janë thelbësore për garantimin e përputhshmërisë me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e të drejtës së informimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Masa ndikon drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së legjislacionit të hartuar nga institucionet publike, uljen e pasaktësive juridike dhe rritjen e transparencës dhe besimit të publikut. Po ashtu, ajo siguron që administrata të jetë në përputhje me kërkesat e BE-së, duke shmangur shkeljet procedurale dhe rreziqet e mosrespektimit të standardeve të privatësisë.

Institucioni përgjegjës : IDP (Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale)

Afati : 2026 - 2027

2. Kapitulli 6 – Përafrimi i legjislacionit për shoqëritë tregtare me Direktivën (BE) 2017/1132

Ky proces konsiston në harmonizimin e kuadrit ligjor kombëtar për shoqëritë tregtare me kërkesat e Direktivës 2017/1132 të BE-së, e cila rregullon aspektet thelbësore të funksionimit të kompanive, përfshirë themelimin, qeverisjen, transparencën dhe mbrojtjen e aksionarëve.

Përafrimi i kësaj direktive synon modernizimin e kuadrit ligjor, rritjen e sigurisë juridike për investitorët, lehtësimin e operimit të biznesit dhe nxitjen e konkurrueshmërisë. Zbatimi i kësaj mase kontribuon në afrimin e Shqipërisë me *acquis communautaire* dhe përmirëson klimën e biznesit, duke e bërë atë më të parashikueshme dhe të sinkronizuar me standardet evropiane.

Institucioni përgjegjës : Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit

Afati : 2026 - 2027

Dimensioni 4 – Mjedisi operacional i NVM-ve

Rekomandime : Rekomandimet fokusohen në digjitalizimin e shërbimeve, lehtësimin e proceseve tatimore dhe vlerësimin e barrës fiskale për SME-të.

Rezultate : Statusi aktual përfshin miratimin e reformave mbi tatimin e të ardhurave, zgjatjen e periudhës së mbartjes së humbjeve tatimore për nxitjen e inovacionit dhe ndërtimin e mekanizmave monitorues. Përmes bashkëpunimit me AKSHI, po zhvillohen shërbime të personalizuar në e-Albania për bizneset, ndërsa janë zgjeruar publikimet me të dhëna të hapura që mbështesin transparencën dhe ripërdorimin nga SME-të.

Për sa më lart, në përputhje me angazhimin e Shqipërisë për rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, vendi ynë ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për

përmirësimin e shërbimeve publike dhe zgjerimin e aksesit ndaj të dhënave të hapura. Si anëtare e Partneritetit për Qeverisje të Hapur (OGP) që nga viti 2011, Shqipëria ka punuar vazhdimisht drejt këtyre synimeve. Një nga zhvillimet më të fundit në këtë drejtim është krijimi i një portali të ri të të dhënave të hapura, i cili prezanton disa risi dhe përmirësime të rëndësishme. Projektuar në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian për platforma të ngjashme, ky portal ofron funksionalitete të avancuara, duke përfshirë një sistem kërkimi të përmirësuar, meta-data me cilësi të lartë për çdo grup të dhënash dhe përputhshmëri me standardin ndërkombëtar DCAT-AP. Për të lehtësuar përdorimin e të dhënave për qytetarët dhe profesionistët në fusha të ndryshme, portali mbështet formate të shumta të lexueshme nga makineritë si JSON, CSV, XML dhe RDF. Për më tepër, platforma sjell performancë të shpejtë dhe një dizajn miqësor për përdoruesit, duke e bërë më të lehtë dhe më efektiv për publikun përdorimin e burimeve të të dhënave të hapura. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) është autoriteti përgjegjës për portalin e të dhënave të hapura. AKSHI, në bashkëpunim me Bankën Botërore në kuadër të programit "Përmirësimi i aksesit të barabartë në shërbimet publike të standardit të lartë nëpërmjet operacionit Govtech", ka angazhuar një kompani për të vlerësuar Gatishmërinë e Shqipërisë për të Dhëna të Hapura. Ky angazhim synon të kryejë një vlerësim të gatishmërisë për të dhënat e hapura për ministritë e identifikuar dhe organet e tyre të varësisë, të prodhojë një Inventar të seteve të të dhënave nga të gjitha ministritë e linjës në gjendje të mbështesin publikimin e të dhënave në Portalin e të Dhënave të Hapura, si dhe të hartojë një plan veprimi dhe strategji për publikimin dhe ripërdorimin e tyre. Ky hap do të kontribuojë drejtpërdrejt në rritjen e numrit dhe cilësisë së të dhënave të publikuara nga institucionet publike, duke krijuar një bazë më të gjerë dhe më të aksesueshme për ripërdorim. Me identifikimin e seteve të reja të të dhënave, udhëzimet për publikim dhe zgjedhjen e licencave të përshtatshme, do të mundësohet një qasje më e hapur dhe e qëndrueshme ndaj informacionit publik. Kjo rritje në disponueshmëri do të përkthehet në më shumë mundësi për NVM-të që të shfrytëzojnë të dhënat për zhvillimin e produkteve, shërbimeve dhe zgjidhjeve inovative, duke nxitur kështu një ekonomi më dinamike të bazuar në të dhëna.

Gjithashtu, sipas raportimit të Ministrisë së Financave, me miratimin e ligjit nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, është parashikuar se duke filluar nga data 1 Janar 2030, të gjitha bizneset do të jenë subjekt i një norme të unifikuar tatimore lidhur me tatimin mbi të ardhurat, pavarësisht kategorisë apo madhësisë së biznesit. Kjo reformë adreson ndikimin shtrembërues të tavanit tatimor të tatimit mbi të ardhurat, duke reduktuar hapësirat për shmangie tatimore.

Administrata tatimore në sajë të analizave të riskut dhe të dhënave nga sistemet tatimore, analizon tatimpaguesit që priren të qëndrojnë pranë pragut prej 14 mln lekë. Këto analiza do të shërbejnë si bazë për monitorim të vazhdueshëm deri në hyrjen në fuqi të normës së unifikuar tatimore më 1 Janar 2030, dhe për vlerësimin e ndikimit të reformës në barrën tatimore dhe në sjelljen e biznesit.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, është parashikuar zgjatja e afatit të mbartjes së humbjeve tatimore nga 3 në 5 vite, duke filluar nga data 1 Janar 2024. Ky ndryshim zbatohet sipas parimit "humbja e parë mbartet më parë se humbja e fundit" dhe synon të ofrojë një mekanizëm më efektiv për përthithjen e humbjeve në vitet pasuese.

Masa është ndërmarrë për të nxitur ndërmarrjet, veçanërisht ato të reja dhe novatore, të rrisin kapacitetet e tyre konkurruese përmes investimeve më të guximshme dhe planeve afatgjata të zhvillimit

Masa të planifikuara për përmirësimin e renditjes:

1. Evidentimi dhe ekspozimi i të dhënave sipas tipologjisë së bizneseve / ndërmarrjeve dhe shërbimeve publike përkatëse nga DPT dhe QKB.

Kjo masë synon evidentimin dhe përfshirjen në mënyre të standardizuar të attributeve që lidhen me madhësinë dhe tipologjinë e bizneseve / ndërmarrjeve (mikro, të vogla, të mesme, të medha) në bazat e të dhënave shtetërore të QKB-së dhe DPT-së, si edhe ekspozimin e këtyre të dhënave për ndërveprim. Paralelisht, institucionet ofruese të shërbimeve do të identifikojnë dhe kategorizojnë shërbimet për bizneset sipas të njëjtave tipologji.

Evidentimi dhe ekspozimi i këtyre të dhënave dhe shërbimeve do mund të bëjë të mundur dhe ofrimin e shërbimeve publike online proaktive dhe të personalizuar përmes e-Albania, për secilin biznes / ndërmarrje. Kjo qasje kontribuon drejtpërdrejt në:

- rritjen e cilësisë së shërbimeve publike për bizneset;
- përmirësimin e përvojës së përdoruesit;
- përafrimin me modelet më të avancuara të qeverisjes digjitale në BE.

Institucionet përgjegjëse: DPT (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve), QKB (Qendra Kombëtare e Biznesit) dhe institucion suportues: AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit).

Afati : 2026 - 2027

1. Zgjerimi i publikimit të të dhënave të hapura në portalin Open Data Albania

Kjo masë synon forcimin e transparencës dhe inovacionit duke rritur numrin dhe cilësinë e dataset-eve të publikuara në portalin kombëtar Open Data Albania. Përfshirja e dataset-eve me potencial ekonomik dhe social krijon mundësi për analizë, zhvillimin e aplikacioneve, shërbimeve dhe produkteve inovative.

Promovimi i ripërdorimit të të dhënave të hapura nga bizneset, akademitë dhe shoqëria civile nxit transformimin digjital dhe krijon vlera të reja ekonomike. Kjo masë është në harmoni me standardet ndërkombëtare të qeverisjes së hapur dhe praktikën e BE-së për transparencë dhe llogaridhënie.

Institucioni përgjegjës : AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit)

Afati : 2026 - 2027

Dimensioni 5a – Shërbimet mbështetëse për SME-të

Rekomandime : OECD thekson nevojën për përmirësimin e aksesit të SME-ve në trajnime, informim dhe mbështetje teknike.

Rezultate : Ministria dhe AIDA kanë realizuar analiza të barrierave, kanë ngritur platforma informuese, kanë pasuruar portalet e aplikimeve dhe ofrojnë mentorime, puntori dhe SME Poëer Hours në fushën e digjitalizimit dhe inovacionit.

Masa të planifikuara për përmirësimin e renditjes:

1. Ulja e barrierave administrative dhe kohore për përfitimin e programeve publike të mbështetjes së biznesit

- Analizimi i procedurave ekzistuese të aplikimit dhe identifikimi i hapave që krijojnë vonesa ose kompleksitet të panevojshëm.
- Propozimi i reformave që reduktojnë dokumentacionin, kohën e shqyrtimit dhe kostot administrative për NVM-të.

Institucioni përgjegjës MEI

Afati : 2026 - 2027

2. Përmirësimi i aksesit në informacion mbi programet e mbështetjes, trajnimeve dhe mundësive të zhvillimit nga AIDA

- Zgjerimi i përmbajtjes së faqes zyrtare të institucionit me informacione të përditësuara, të strukturuar dhe të lehtësisht të aksesueshme.
- Pasurimi i platformës “Aksesi në Financë” me të dhëna për programet, afatet, kriteret dhe udhëzuesit e aplikimit.
- Krijimi i kanaleve të komunikimit interaktiv (FAQ, video shpjeguese, ëebinare orientuese).

Institucioni përgjegjës : AIDA

Afati : 2026 - 2027

3. Rritja e kapaciteteve të NVM-ve përmes mentorship-it, ëorkshop-eve dhe trajnimeve praktike

- Organizimi i aktiviteteve tematike në fushat e digjitalizimit, ekonomisë së gjelbër,
- Realizimi i ditëve informuese, punëtorive praktike dhe aktiviteteve të rrjetëzimit (p.sh. SME Poëer Hours) në kuadër të projekteve zbatuese.
- Mbështetja e ndërmarrjeve me programe ndërtimi kapacitetesh që lidhen drejtpërdrejt me përmirësimin e performancës së tyre digjitale dhe të gjelbër.

Institucioni përgjegjës : AIDA

Afati : 2026 - 2027

Dimensioni 5b – Prokurimi publik

Rekomandime : Rekomandimet kërkojnë përputhje më të madhe me standardet e BE-së dhe monitorim të pjesëmarrjes së NMV-ve.

Rezultate : Statusi tregon se ligji i ri i prokurimit publik përfshin lehtësira konkrete për SME-të, ndërsa raportet vjetore të APP-së tashmë përfshijnë seksione të dedikuara me statistika të detajuara për pjesëmarrjen e tyre. Po kërkohet bashkërendim me DPT për kategorizimin e operatorëve ekonomikë si SME.

Për sa më lart, Agjencia e Prokurimit Publik ka ndërmarrë hapa të qartë dhe të matshëm për zbatimin e rekomandimeve që lidhen me nxitjen e pjesëmarrjes së NVM-ve në procedurat e prokurimit publik. Ligji nr. 162/2020, i ndryshuar, inkorporon dispozita specifike që synojnë lehtësimin e aksesit të NVM-ve në prokurim, duke reflektuar në mënyrë të plotë kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Europian. Amendimet ligjore të miratuara gjatë vitit 2024 përafruan më tej kuadrin rregullator me direktivat europiane, veçanërisht në aspektet që forcojnë mbështetjen për operatorët ekonomikë të vegjël dhe të mesëm, duke krijuar kushte më të favorshme për pjesëmarrjen e tyre.

Që prej vitit 2022, APP ka integruar në Analizat e saj Vjetore një seksion të dedikuar për monitorimin e performancës së NVM-ve në prokurime, ku raportohen në mënyrë sistematike përqindjet e procedurave të fituara nga këto ndërmarrje, si në numër, ashtu edhe në vlerë. Kjo praktikë ka kontribuar në rritjen e transparencës, në monitorimin e trendëve dhe në vlerësimin e impaktit të reformave të ndërmarra.

Në kuadër të raportimit më të fundit të SME Policy Index, APP ka ofruar të dhëna të detajuara mbi përqindjen në vlerë të kontratave të dhëna NVM-ve, si dhe mbi pjesëmarrjen dhe procedurat e fituara prej tyre, duke reflektuar kështu një angazhim të qëndrueshëm për sigurimin e një panorame të qartë dhe të matshme të përfshirjes së NVM-ve në sistemin e prokurimit publik.

Megjithatë, për të siguruar vërtetësinë dhe plotësinë e të dhënave, APP vijon të mbështetet te informacioni i siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve lidhur me kategorizimin e operatorëve ekonomikë sipas kriterëve ligjore të përcaktuara për NVM-të. Kjo varësi nënvizon nevojën për rritjen e shkëmbimit ndër-institucional të të dhënave dhe për krijimin e mekanizmave më të automatizuar të verifikimit.

Në këtë drejtim, një hap i rëndësishëm është nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit me QKB, ku një nga fushat kryesore të zbatimit lidhet me matjen e indikatorëve për monitorimin e pjesëmarrjes së NVM-ve në prokurim. Ky instrument institucional synon të forcojë shkëmbimin e informacionit dhe të përmirësojë bazën e të dhënave të APP-së, duke krijuar mundësi për analiza më të thelluara dhe politika më të targetuara në mbështetje të NVM-ve.

Dimensioni 6 – Akses i financës

Rekomandime : OECD synon forcimin e instrumenteve financiare, rritjen e fondeve dhe promovimin e burimeve alternative të financimit.

Rezultate : Shqipëria ka ndërmarrë masa për rritjen e fondeve të granteve, përmirësimin e platformës “Access to Finance”, krijimin e skemave për start-up dhe inovatorë dhe ofrimin e udhëzuesve të posaçëm. Është miratuar Strategjia Kombëtare për Edukimin Financiar 2024-2026, ndërsa mbështetet nisma për ligjin e croëdfunding.

Për sa më lart, Përgjatë vitit 2025, Banka e Shqipërisë ka vënë në dispozicion një fond prej 25 miliardë ALL për të mbështetur financimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme. Ky program, i cili do të zbatohet përmes bankave tregtare, ofron mundësinë e uljes së ndjeshme të kostos së kreditit për këto ndërmarrje, e cila mund të arrijë deri në 2%, por në çdo rast nuk do të tejkalojë nivelin e 3.5%, duke u mundësuar atyre të investojnë në pasuri të paluajtshme, pajisje kapitale ose platforma teknologjike që shërbejnë për rritjen e produktivitetit.

Gjate vitit 2025 u miratua nga KM projektligji për krijimin e Bankës Shqiptare të Zhvillimit.

Objektivat kryesorë të këtij institucioni, janë mbështetja me hua e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe startup-et, veçanërisht ato që operojnë në sektorë që përballen me vështirësi në financim.

Sa i përket rritjes së ndërgjegjësimit për instrumentet financiare jobanka dhe mbështetjes së përdorimit të tyre, Banka e Shqipërisë ka intensifikuar licensimet në aktivitetet që i përkasin në leasing-ut, factoring-ut, kompanitë fintech dhe institucionet e parasë elektronike, si dhe ka transpozuar direktivën evropiane PSD2. Banka e Shqipërisë ka licensuar deri tani dy Institucione Pagesash të cilat mund të shfrytëzojnë Open Banking dhe të ofrojnë shërbime të Inicimit të Pagesave apo shërbime të Informimit të Llogarisë së Pagesave, gjithashtu tashmë janë bërë dhe transaksionet e para live në kanalet Open Banking midis këtyre institucioneve dhe bankave.

Masa të planifikuara për përmirësimin e renditjes:

1. Grantet për NVM për vitin 2026, të parashikuara në kuadër të alokimit të fondit PBA 2026, synojnë hartimin dhe zbatimin nga MEI dhe AIDA të një skeme të strukturuar mbështetëse që përcakton kriteret e përzgjedhjes, mekanizmat e monitorimit dhe shpërndarjen efikase të fondeve për të nxitur zhvillimin e bizneseve të vogla dhe të mesme.

Institucioni përgjegjës : MEI/AIDA

Afati : 2026

2. MEI ka hartuar një guide–Udhëzues për të informuar lidhur me aplikimet e entiteteve shqiptare për propozimet për projekte me objekt ndërkombëtarizimin e tyre. Qëllimi i guidës është të shërbejë si një burim informacioni për palët e interesuara në Shqipëri – veçanërisht autoritetet publike kombëtare dhe lokale, institucionet, bizneset, OJQ-të, akademinë dhe profesionistët – se si të aksesojnë fonde për projektet e tyre nga një numër programesh financimi të BE-së, si dhe mundësi të tjera të ndryshme financimi ku Shqipëria është e kualifikuar/potencialisht e kualifikuar për të aplikuar. Gjithashtu, gjatë vitit 2025 janë organizuar sesione informuese dhe seminare trajnimi për të mundësuar rritjen e ndërgjegjësimit dhe aplikimet në projekte, duke përfshirë këtu edhe thirrjet për aplikime në kuadër të Single Market.
3. Skemë financiare për “Start-up dhe Inovatorë”.

Institucioni përgjegjës : MEI/Agjencia Start Up Albania

Afati : 2026 - 2027

4. AIDA: Përmirësimi i platformës “Access to Finance” me funksionalitete të reja për filtrimin e instrumenteve financiare (bankare, jo-bankare, croëdfunding, grante, kapital sipërmarrës). (ëbsite aksesit në finance)

Institucioni përgjegjës : AIDA

Afati : 2026 - 2027

5. Organizimi i fushatave informuese për përdorimin e instrumenteve alternative të financimit për NVM-të.

Institucioni përgjegjës : MEI

Afati : 2026 - 2027

6. Monitorimi i kreditimit të Microfinancës. Rritja e aktiviteteve të leasing, factoring. Licensimi i kompanive fintech dhe Electronic Money Institutions dhe rritja e aktivitetit të tyre. Transpozimi i direktivës evropiane PSD2.

Institucioni përgjegjës :Banka e Shqipërisë

Afati : 2026 - 2027

7. Hartimi i FAS Survey Pilot për 2026 duke implementuar indikatorët e rinj për shpërndarjen gjinore, grupmoshave dhe vendndodhjes. Mbledhja e informacioneve të detajuara për institucionet banka, jobanka dhe fintech.

Institucioni përgjegjës :Banka e Shqipërisë

Afati : 2026

8. Hartimi i ligjit për financim – Ligji për Croëdfunding dhe Ligji për Byrotë e Kredive.

Institucioni përgjegjës : Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë

Afati : 2026 - 2027

Dimensioni 7 – Standardet dhe rregulloret teknike

Rekomandime : Rekomandimet synojnë ofrimin e informacionit në një faqe të vetme dhe zgjerimin e marrëveshjeve ndërkombëtare të akreditimit.

Rezultate : Statusi në Shqipëri përfshin rritjen e transparencës për SME-të, zgjerimin e fushës së akreditimit, aplikimin për marrëveshjet EA-MLA dhe përmirësimin e kuadrit të metrologjisë. Janë hedhur hapat drejt krijimit të regjistrit elektronik të etaloneve dhe shërbimeve digjitale për bizneset.

Masa të planifikuara për përmirësimin e renditjes:

1. Rritja e ofrimit të informacionit publik për NVM-të, duke publikuar rregullisht kërkesat ligjore, standardet e sigurisë dhe informacionet e lidhura me mbikëqyrjen e tregut, me qëllim rritjen e transparencës dhe përmirësimin e përputhshmërisë së bizneseve.

Institucioni përgjegjës : ISHMT

Afati : 2026

2. Ofrimi i shërbimeve institucionale për NVM-të në mënyrë elektronike përmes faqes zyrtare, duke digjitalizuar procedurat dhe reduktuar barrën administrative për bizneset.

Institucioni përgjegjës : ISHMT

Afati : 2026

3. Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet DPS dhe AIDA, përmes së cilës faqja e DPS lidhet me faqen e AIDA-s, DPS ofron informacion për çdo standard të kërkuar nga bizneset dhe AIDA përfshihet në listën e grupeve të interesit për marrjen periodike të Buletinëve informativë të DPS.

Institucioni përgjegjës : Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit

Afati : 2026

4. Fillimi i aktivitetit të ri të akreditimit në fushën e certifikimit të produktit, duke aplikuar për anëtarësimin e Shqipërisë në Agjencinë Europiane të Akreditimit (EA) dhe nënshkruar tre marrëveshjet EA-MLA për laboratorët kalibruues, laboratorët mjekësorë dhe certifikimin e produktit, si dhe sigurimi i mbajtjes së statusit pas nënshkrimit.

Institucioni përgjegjës : Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit

Afati : 2025 - 2028

5. Rishikimi i paketës ligjore për metrologjinë me qëllim harmonizimin e plotë me acquis communautaire të Bashkimit Europian dhe modernizimin e kornizës rregullatore të matjeve.

Institucioni përgjegjës : Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë

Afati : 2026 - 2027

6. Krijimi i një regjistri elektronik për instrumentet matëse në të gjithë vendin, i cili do të përfshijë statusin e verifikimit, subjektet e autorizuar për inspektim dhe të dhëna relevante për konsumatorët, institucionet publike dhe operatorët ekonomikë.

Institucioni përgjegjës : Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë

Afati : 2026 - 2027

7. Akreditimi i shërbimeve të kalibrimit në fushat e matjeve të temperaturës, madhësive elektrike, matjeve dimensionale dhe kategori të tjera, për të garantuar gjurmueshmëri metrologjike dhe për të mbështetur konkurrueshmërinë teknike të NVM-ve.

Institucioni përgjegjës : Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë

Afati : 2026 - 2027

8. Pjesëmarrja në krahasime ndër-laboratorike rajonale (EURAMET) dhe ndërkombëtare (BIPM) për të validuar kompetencën teknike të laboratorëve të standardeve kombëtare të matjes dhe për të siguruar krahasueshmëri ndërkombëtare.

Institucioni përgjegjës : Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë

Afati : 2026 - 2027

9. Ratifikimi i Marrëveshjes së anëtarësimit të Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare të Metrit (BIPM), për të përmbushur objektivat institucionale dhe kriteret teknike të kërkuara për institucionet metrologjike kombëtare.

Institucioni përgjegjës : Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë

Afati : 2026 - 2027

Dimensioni 8a – Aftësitë e sipërmarrjes

Rekomandime : OECD kërkon një qasje gjithëpërfshirëse mbi inteligjencën e aftësive dhe ngritjen e komiteteve sektoriale.

Rezultate : Në Shqipëri ka filluar hartimi i programeve të aftësive për SME-të dhe është themeluar Komiteti Sektorial i Energjisë, me planifikimin për krijimin e komiteteve të tjera në vitet në vijim.

Masa të planifikuara për përmirësimin e renditjes:

Identifikimi përmes analizave të nevojave për aftësi, i nevojave për fuqi punëtore dhe llojit të aftësive të nevojshme për përmbushjen e funksioneve të sipërmarrjeve.

Institucioni përgjegjës : AKPA

Afati : 2026

1. Dhënia e prioritetit për krijimin e Komiteteve sektoriale të aftësive, siç përshkruhet në Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, si një rrugë për të mbështetur kuptimin më të madh të nevojave për aftësi të tregut të punës dhe për të inkurajuar bashkëpunimin ndërmjet arsimit dhe biznesit. Krijimi i Komitetit të IV Sektorial në vitin 2026

Institucioni përgjegjës : AKAFPK

Afati : 2026

Dimensioni 8b – Politikat e inovacionit

Rekomandime : Rekomandimet synojnë përmirësimin e mbledhjes së të dhënave, rritjen e mbështetjes financiare dhe krijimin e një ekosistemi të inovacionit.

Rezultate : Aktualisht po ngrihen hapësira inovative (Innovation Hub), një Regjistër Kombëtar i Inovacionit, fonde kombëtare për inovacionin dhe platforma të bashkëpunimit biznes–akademi. Janë ndërmarrë edhe masa për standardet e përdorimit të teknologjive si AI dhe për përditësimin e ligjit për Start-Up-et.

Masa të planifikuara për përmirësimin e renditjes:

1. Amendimi i Ligjit Nr. 25/2022 “Për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Start-up-eve”, me qëllim përditësimin e kornizës ligjore sipas praktikave më të mira europiane dhe nevojave të ekosistemit të inovacionit dhe të sektorit privat.

Institucioni përgjegjës : MEI

Afati : 2026

2. Krijimi i hapësirave inovative (Innovation Hub) për rritjen e kapaciteteve të SME-ve dhe start-up-eve në përdorimin e teknologjive të avancuara, duke ofruar laboratorë testimi, trajnime digjitale dhe mundësi bashkëpunimi ndërmjet aktorëve ekonomikë, akademikë dhe komunitetit të inovacionit.

Institucioni përgjegjës : MEI

Afati : 2027

3. Krijimi i Platformës për Bashkëpunim Biznes–Kërkim (Innovation Match Platform), me synim forcimin e lidhjeve ndërmjet sektorit privat dhe institucioneve akademike për projekte kërkimore, inovative dhe teknologjike.

Institucioni përgjegjës : MEI

Afati : 2026/7

4. Integrimi dhe përdorimi i mjetit të vetëvlerësimit të inovacionit (IRS Toolkit) për NMV-të dhe aktorët e ekosistemit, me qëllim identifikimin e nivelit të gatishmërisë inovative dhe planifikimin e ndërhyrjeve për përmirësim.

Institucioni përgjegjës : AIDA

Afati : 2026

5. Organizimi i “Green Innovation Labs”, ërkshop-e praktike që ndërthurin inovacionin digjital dhe të gjelbër për SME-të në sektorët e turizmit, agropërpunimit dhe prodhimit, duke përfshirë krijimin e modulit për “Green Innovation Lab” dhe përdorimin e IRS Toolkit. Ofrimi i këshillimit për zhvillimin e teknologjive të sigurta të inovacionit, përfshirë AI, big data dhe cloud computing, në përputhje me standardet europiane të sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave.

Institucioni përgjegjës : AIDA

Afati : 2026

6. Ofrimi i këshillimit për zhvillimin dhe adoptimin e teknologjive të sigurta të inovacionit (Fokus te teknologjitë si inteligjenca artificiale, big data dhe cloud computing. Sigurimi që zgjidhjet teknologjike të jenë në përputhje me standardet kombëtare dhe evropiane të mbrojtjes së të dhënave).

Institucioni përgjegjës : IDP (Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale)

Afati : 2026

7. Hartimi i udhëzimeve për përputhshmëri etike dhe ligjore në përdorimin e AI nga SME-të (Përfshirja e kërkesave për privatësinë, mbrojtjen e të dhënave, transparencën dhe përdorimin e përgjegjshëm të teknologjive të automatizuara. Trajnime praktike për zbatimin e standardeve etike dhe rregullatore).

Institucioni përgjegjës : IDP (Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale)

Afati : 2026

8. Mbështetja e projekteve të teknologjisë dhe inovacionit në bashkëpunim universitet–biznes
 - Nxitja e projekteve të përbashkëta kërkimore, transferimit të dijes dhe zhvillimit të produkteve apo proceseve të reja teknologjike. Krijimi i skemave specifike që favorizojnë partneritetet industriale me institucionet akademike.
 - Hartimi dhe publikimi i thirrjeve për aplikime për projekte të teknologjisë dhe inovacionit
 - Përgatitja e kriterëve, dokumentacionit orientues dhe procedurave të aplikimit.
 - Sigurimi i transparencës dhe aksesit të barabartë për të gjithë aplikantët.
 - Organizimi i sesioneve informuese për aplikantët potencialë
 - Sesione informuese online dhe fizike për të shpjeguar kërkesat, prioritetet dhe fazat e procesit të aplikimit.

- Mbështetje teknike për hartimin e projekteve konkurruese.
- Vlerësimi, përzgjedhja dhe financimi i projekteve të teknologjisë dhe inovacionit
- Krijimi i komisioneve të vlerësimit me ekspertizë teknike dhe akademike.
- Proces transparent për përzgjedhjen e projekteve fituese.
- Ofrimi i financimit dhe monitorimit të zbatimit të projekteve të mbështetura.

Institucioni përgjegjës : Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit

Afati : 2026

Dimensioni 9 – SME-të në një ekonomi të gjelbër

Rekomandime : OECD rekomandon koordinim ndërsektorial, rritje të financimit dhe integrim të instrumenteve rregullatore.

Rezultate : Statusi aktual përfshin integrimin e objektivave të gjelbërimit në strategjitë kombëtare, rritje të aksesit në financë për gjelbërimin dhe hartimin e udhëzuesve praktikë për incentiva. Po zhvillohen gjithashtu rregullore sektoriale në turizëm dhe dokumente orientuese për bizneset.

Masa të planifikuara për përmirësimin e renditjes:

1. Hartimi i taksonomisë së gjelbër kombëtare në përputhje me standardet europiane, me qëllim krijimin e një kornize të unifikuar klasifikimi për aktivitetet ekonomike të qëndrueshme dhe orientimin e investimeve drejt sektorëve të gjelbër.

Institucioni përgjegjës : Banka e Shqipërisë

Afati : 2026 - 2027

2. Rritja e aksesit në financa për NVM-të përmes sesioneve informuese, seminareve të trajnimit dhe aktiviteteve ndërgjegjësuere që synojnë rritjen e njohurive dhe aftësive të sipërmarrjeve për të aplikuar në projekte financimi me fokus ekonominë e gjelbër, përfshirë thirrjet në kuadër të programit SMP.

Institucioni përgjegjës : MEI

Afati : 2026 - 2027

3. Hartimi i një rregulloreje për strukturat akomoduese, agjencitë e udhëtimit dhe bizneset mbështetëse mbi standardet e qëndrueshmërisë dhe certifikimet mjedisore, duke përgatitur një dokument orientues për sipërmarrjet mbi incentivat e gjelbërimit, burimet e financimit dhe mbështetjen publike.

Institucioni përgjegjës : Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit

Afati : 2026 - 2027

4. Hartimi i një udhëzuesi praktik për incentivat për gjelbërimin e NVM-ve (EU for Green), që përshkruan instrumentet financiare, grantet, kreditë e buta dhe mekanizmat mbështetës për ndërmarrjet që investojnë në teknologji dhe zgjidhje të qëndrueshme.

Institucioni përgjegjës : Ministria e Mjedisit

Afati : 2026

5. Hartimi i Strategjisë Afatmesme për Financat e Gjelbra 2026–2029, që përcakton objektivat kombëtare për financimin e qëndrueshëm, zhvillimin e tregjeve të gjelbra dhe instrumenteve financiare të orientuara drejt tranzicionit klimatik dhe mjedisor.

Institucioni përgjegjës : Banka e Shqipërisë

Afati : 2026 - 2027

Dimensioni 10 – Ndërkombëtarizimi i SME-ve

Rekomandime : Rekomandimet nënvizojnë krijimin e një mjedisi që mbështet digjitalizimin dhe tregtinë elektronike, si dhe sigurimin e zbatimit të strategjive të eksportit.

Rezultate : Statusi në Shqipëri përfshin hartimin e programit të eksportit, funksionimin e platformës së eksportit dhe NEXTeen, intensifikimin e B2B-ve dhe misionëve të biznesit, fushatat digjitale promovuese dhe rishikimin e planit të veprimit për e-commerce. Gjithashtu, po hartohen programe mentorimi për eksportuesit e rinj dhe masa për mbrojtjen e të dhënave në tregtinë elektronike.

Gjithashtu, procesi i Monitorimit dhe Rishikimit të Strategjisë BIDS 2021-2027 ka përfunduar në shtator 2025, duke rishikuar vizionin e strategjisë për t'u përshtatur me procesin dhe objektivat në kuadër të integrimit evropian, duke vendosur në qendër edhe digjitalizimin e NMV-ve. Vizioni i ri synon një ekonomi shqiptare konkurruese, më të orientuar drejt inovacionit dhe të bazuar në njohuri, të integruar në Bashkimin Evropian dhe rajon, që krijon vende pune të reja e cilësore për gratë dhe burrat, duke shfrytëzuar potencialet e tranzicionit digjital dhe të gjelbër si dhe transformimet e zinxhirit ndërkombëtar të vlerës, duke theksuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe të barabartë.

Masa të planifikuara për përmirësimin e renditjes:

1. Hartimi i programit të eksportit në kuadër të Agjëndës Kombëtare të Reformave.

Institucioni përgjegjës : MEI

Afati : 2025 - 2026

2. Krijimi dhe funksionalizimi i platformës së eksportit dhe NEXTeen për gjetjen e partneriteteve dhe mbledhjen e shprehjeve të interesit (EoI) nga bizneset.

Institucioni përgjegjës : AIDA

Afati : 2026

3. Përfshin mbështetjen e AIDA-s për rritjen e bashkëpunimeve B2B, planifikimin e panairëve, misionëve të biznesit dhe organizimin e eventeve B2C.

Institucioni përgjegjës : AIDA

Afati : 2026

4. Zhvillimi i një fushate digjitale promovuese për eksportet shqiptare, me synim rritjen e dukshmërisë ndërkombëtare të produkteve dhe shërbimeve vendase.

Institucioni përgjegjës : AIDA

Afati : 2026 - 2027

5. Rishikimi dhe përditësimi i planit të veprimit për e-commerce, me qëllim modernizimin dhe përafrimin me standardet bashkëkohore.

Institucioni përgjegjës : MEI

Afati : 2026 - 2027

6. Hartimi dhe monitorimi i një programi vjetor eksporti të dedikuar për NMV-të dhe për produkte/produkte të caktuara.

Institucioni përgjegjës : MEI

Afati : 2026 - 2027

7. Zhvillimi i një fushate ndërgjegjësimi për konsumatorin lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale në kuadër të platformave të e-commerce.

Institucioni përgjegjës : MEI

Afati : 2026

Dimensioni 11: Transformimi Digjital i NMV-ve

Është një dimension i ri i përfshirë në edicionin e ri të Raportit të OECD SME Policy Index 2026. Dimensionin e transformimit digjital të NMV-ve vlerëson adoptimin dhe integrimin e mjeteve dhe teknologjive të ndryshme digjitale nga NMV-të, krahas politikave dhe mekanizmave mbështetës të qeverisë për të lehtësuar përvetësimin e këtyre teknologjive në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi. Duke përfshirë pyetje rreth:

1. Politikave dixhitale,
2. Sigurinë dixhitale
3. Përdorimin e teknologjive të avancuara

Dimensioni nënvizon rëndësinë e përvetësimit të teknologjive të avancuara nga ana e NVM-ve si dhe garantimin e sigurisë kibernetike nga ana e qeverisë me anë të mekanizmave ligjorë dhe autoriteteve përkatëse.

Masa të planifikuara:

1. Forcimi i ndërgjegjësimit dhe informimit mbi mundësitë e financimit evropian në fushën e transformimit digjital

Rritja e ndërgjegjësimit të institucioneve publike, biznesit dhe aktorëve të tjerë mbi thirrjet e Komisionit Evropian në kuadër të Programit Digjital të Bashkimit Evropian (DEP), duke synuar rritjen e pjesëmarrjes së aktorëve shqiptarë në projekte transformuese që mbështesin digjitalizimin, inovacionin dhe adoptimin e teknologjive të reja. Masat përfshijnë informim të strukturuar, seminare orientuese, dhe asistencë teknike për aplikim.

Institucioni përgjegjës :Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe AKSHI

Afati : 2025 - 2027

2. Promovimi i edukimit të NMV-ve në fushën e teknologjisë dhe sigurisë kibernetike

Në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025–2030, kjo masë synon të nxisë rritjen e njohurive dhe aftësive të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NMV) në lidhje me sigurinë kibernetike, praktikatat e parandalimit të sulmeve dhe përdorimin e teknologjive të sigurta. Përfshin fushata ndërgjegjësimi, module trajnimi dhe materiale edukative të orientuara drejt sektorit privat.

Institucioni përgjegjës : Autoriteti Kombëtar i Sigurisë Kibernetike (AKSK)

Afati : 2025 - 2027

3. Përgatitja e udhëzimeve mbi masat e sigurisë kibernetike të NMV-të

Përgatitja e një pakete udhëzuese që përcakton masat minimale dhe të rekomanduara për sigurinë kibernetike, të personalizuar për nevojat e NMV-ve. Udhëzimet synojnë të standardizojnë praktikatat bazë të sigurisë, të ndihmojnë bizneset të identifikojnë risket dhe të implementojnë zgjidhje me kosto të përballueshme.

Institucioni përgjegjës : Autoriteti Kombëtar i Sigurisë Kibernetike (AKSK)

Afati : 2026 - 2027

4. Organizimi i trajnimeve vjetore të dedikuara për punonjësit e NMV-ve

Krijimi i një cikli trajnimesh të specializuara për punonjësit e NMV-ve mbi përdorimin e teknologjive digjitale, sigurinë e të dhënave dhe standardet e qëndrueshmërisë teknologjike. Masat synojnë përmirësimin e kapaciteteve teknike dhe reduktimin e dobësive kibernetike brenda sektorit privat.

Institucioni përgjegjës : Autoriteti Kombëtar i Sigurisë Kibernetike (AKSK)

Afati : 2026-2027

5. Miratimi i Strategjisë Kombëtare për Inteligjencën Artificiale

Finalizimi dhe miratimi i dokumentit strategjik që përcakton vizionin, objektivat dhe prioritetet kombëtare për zhvillimin dhe përdorimin e Inteligjencës Artificiale në Shqipëri. Dokumenti do të përfshijë çështje që lidhen me etikën, të drejtat e njeriut, zhvillimin e kapaciteteve, inovacionin dhe përdorimin e AI-së në administratë dhe sektorin privat.

Institucioni përgjegjës : AKSHI

Afati : 2026

6. Miratimi i Strategjisë Ndërsektoriale “Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2027–2031”

Përgatitja dhe miratimi i strategjisë afatgjatë që udhëheq transformimin digjital të vendit në periudhën 2027–2031. Strategjia do të fokusohet në zhvillimin e infrastrukturës digjitale, rritjen e shërbimeve elektronike, sigurinë kibernetike, adoptimin e teknologjive të reja dhe rritjen e aftësive digjitale të popullsisë dhe bizneseve.

Institucioni përgjegjës : AKSHI

Afati : 2027 (q1)

Plan Veprimi për Përmirësimin e Renditjes së Shqipërisë në Indeksin e OECD-së për Politikat e SME-ve
2026-2027

Nr	Dimensionet	Nëndimensionet	Rekomandimet e OECD (prioritete)	Masat	Institucionet përgjegjëse	Afati kohor
1	1. Të mësuarit sipërmarrës dhe sipërmarrja e grave	1.1. Mësimi sipërmarrës. 1.2. Sipërmarrja e grave	a) Krijimi i një partneriteti kombëtar për të mbështetur sipërmarrësit dhe sipërmarrja e grave.	Mbështetje për programe pilot në universitete.	Ministria e Arsimit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar	2026-2027
				Mbështetje për programe pilot në universitete. (Kurse trajnimi për pedagogë, sipërmarrës)	Ministria e Arsimit	2026-2027
				Partneritete me inkubatorë dhe sektorin privat (Praktika profesionale dhe projekte të aplikuar)	Ministria e Arsimit	2026-2027
				Bashkëpunim me Donatorë. Udhja me Entrecomp (Harmonizim i metodologjive dhe indikatorëve të raportimit)	Ministria e Arsimit	2026-2027
				Krijimi i një njëti kontakti për të njohur donatorët me projektet dhe veprimtarinë kërkimore, sipas fushës së interesat. (Angazhimi në rritjen dhe fuqizimin e vajzave dhe grave, duke i përfshirë në veprimtari kërkimore shkencore, me anë të bashkëpunimeve dhe thirrjeve të hapura (Open MA Call) me tematika navatore dhe prioritare si në fushën e biznesit dhe atë akademikut)	Ministria e Arsimit	2026-2027
			b) Harmonizimi i programuesve të trajnimit të mësuesve universitarë me EntreComp.	Rishikimi i kurrikulave duke u përqëndruar në shkrimin e peshës së veprimtarive praktike në procesin mësimor.	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar	2026-2027
				Zhvillimi i një trajnimi në nivel kombëtar për mësuesit e arimit profesional mbi modulën e sipërmarrjes në funksion të zbatimit sa më të lartë të tij.	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit	2026-2027
			c) Të integrohet zhvillimi i sipërmarrjes të kurrikulës në përpjetje me EntreComp	Workshop dhe Open call për pjesëmarrje. (Angazhimi i stafëve profesionalë për hartimin e projekteve dhe angazhimin e vajzave dhe grave në veprimtari kërkimore).	Ministria e Arsimit	2026-2027
			d) Statistika dhe raporte të ndikimit të programeve që mbështesin sipërmarrjen e grave.	Antarësimi i Bankës së Shqipërisë në WE-FI code. (Women Entrepreneur Finance Indusion)	Banka e Shqipërisë	2026-2027
				Përgatitja dhe publikimi i statistikave mbi numrin e vajzave/grave të përfshira në kurset profesionale që trajtojnë aftësitë sipërmarrëse të ofruera nga ofruesit publik të AFP. Publikimi i rasteve të suksessit të grave sipërmarrëse të mbështetura nga programi i vetëpunësimit	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	2026-2027
				Rritja e vlerës së financimit në programin e vetëpunësimit	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	2026-2027
				Ndërgjegjësim për rritjen e investimeve private në veprimtari kërkimore me bazë fushat e interesit, duke incentivuar kandidatet. (Ofrimi i një certifikate stashi ose pjesëmarrje në veprimtarinë dhe iniciativën kërkimore shkencore)	Ministria e Arsimit	2026-2027
2	2. Falimentimi dhe shansi i dytë	2.1: Procedurat e falimentimit. 2.2: Promovimi i shansit të dytë	a) Masa e politika për parandalimin e falimentimit, ndërmjet sistemit të paralojndimit të hershëm (Direktiva e BE-së 1029/2019)	Zbatimi i Sistemit Kombëtar të Paralojndimit të Hershëm (Early Warning System), në përpjetje me Direktivën (BE) 2019/1023.	Drejtoria e Përgjithshme e Tëtimeve, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia e Falimentit	2026-2027
				Hartimi i udhëzimeve për menaxhimin e krizës financiare dhe diagnostikimin e hershëm të rrethit për NVM-të.	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia e Falimentit	2026-2027
				Krijimi i Qendrave të Këshillimit për Parandalimin e Falimentimit pranë Agjencisë Kombëtare të Falimentimit dhe Oqumave të Tregtisë.	Ministria e Ekonomisë, Agjencia e Falimentit	2026-2027
				Fushata kombëtare për ndërgjegjësim mbi parandalimin e borxheve të keqja dhe menaxhimin financiar.	Ministria e Ekonomisë, Banka e Shqipërisë, Agjencia e Falimentit	2026-2027
			b) Thjeshtimi i procesit të likuidimit duke futur mjete dixhitale, anëtarës elektronikë dhe mekanizmat automatike të shpërndarjes elektronike, sipas shembullit të Maqedonisë së Veriut	Digitalizimi i procesit të falimentimit (enkkande elektronike)	Agjencia e Falimentit, QKB, Drejtoria e Përgjithshme e Tëtimeve	2026-2027
			c) Ndëryshimi i rregulloreve për marrëveshjet e përfshijtura të riorganizimit jashtëgjyqësor	Rishikimi i rregulloreve për marrëveshjet jashtëgjyqësore të riorganizimit.	Agjencia e Falimentit	2026-2027
			d) Përmirësimi i procedurave formale të riorganizimit të falimentimit.	Përmirësimi i kuadrës ligjor për falimentimin personal dhe reduktimi i periudhës së faljes së borxhit në maksimum 3 vite.	Ministria e Ekonomisë, Agjencia e Falimentit	2026-2027
			e) Promovimi i mundësia të dytë për sipërmarrësit e ndershëm.	Fushata kombëtare e ndërgjegjësimit "Një shans i dytë për sipërmarrësit e ndershëm".	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Agjencia e Falimentit	2026-2027
				Zhvillimi i programit të rikthimit në treg (Re-entry Programme) për sipërmarrësit që kanë lëshuar falimentimin	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Agjencia e Falimentit	2026-2027
				Krijimi i Komitetit Ndërinstitucional për Falimentimin dhe Shansin e Dytë.	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Agjencia e Falimentit	2026-2027
				Hartimi i treguesve të performancës (KPI) për vlerësimin e impaktit.	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Agjencia e Falimentit	2026-2027
				Raportim vjetor ndaj OECD dhe BE mbi progresin e reformave.	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Agjencia e Falimentit	2026-2027
3	Kuadrë institucional dhe rregullator për politikëbërjen e NVM	3.1. Kuadrë institucional 3.2. Thjeshtësimi legjislativ dhe analize e ndikimit rregullator (RIA) 3.3. Konsultimi Publik-Privat (PPC)	a) Zhvillimi i një programi për thjeshtimin legjislativ dhe reduktimin e barrës administrative.	Trajnimi i administratës publike në kuadrë të reagjektivitetit, gjatë procesit të hartimit të akteve, të përkrahurit të legjislatimit përkatës për të drejtën e informimit dhe mbrojtjes së të dhënave	IDP (Komisioni për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale)	2026-2027
			b) Focsimi i kontrolit të cilësisë së analizës së ndikimit rregullator.	Raportimi 6 – Përfundimi i legjislatimit për shoqëritë tregtare me direktivën 2017/1132 e BE për Shoqëritë Tregtare.	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit	2026-2027
			c) Prezantimi i monitorimit dhe vlerësimit të përfundim të analizës së ndikimit rregullator.	Realizuar nga AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	2026-2027
4	4. Mjedisat operacionale për NVM-të	4.1. Shërbime të qeverisë dixhitale 4.2. Regjistrimi i kompanive 4.3. Licencimi i biznesit 4.4. Procedurat e përfundimtare të tetimeve për NVM-të	a) Rrethimi elektronik nga NVM, ulje e kosteve dhe barrierë teknologjike.	Evidentimi dhe ekpozimi i të dhënave sipas tipologjisë së bizneseve / ndërmarrjeve dhe shërbimeve publike përkatëse nga DPT dhe QKB.	Drejtoria e Përgjithshme e Tëtimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	2027
			b) Prezantimi i monitorimit dhe vlerësimit të performancës së shërbimeve dixhitale të NVM.	Zgjerimi i publikimit të të dhënave të hapura në portalin kombëtar Open Data Albania, duke përfshirë dataset e me potencial ekonomik dhe social, si dhe promovimi i ripërdorimit të tyre për shërbime e produkteve dhe shërbimeve inovative.	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	2026-2027
			c) Promovimi i ripërdorimit të të dhënave të qeverisë së hapur nga NVM-të.			2026-2027

			d) Vlerësim i barrës tatimore të NVM, për ndikimin shtrembërues të tavanaeve tatimore.	Zbatimi i normës së unifikuar të tatimit mbi të ardhurat (duke hyrë në fuqi më 1 Janar 2030)	Ministria e Financave	realizuar Analiza tatimore deri në 31 dhjetor 2029. Zbatimi i ligjit nga data 1 Janar 2030.
			e) Monitorim i barrës tatimore për NVM e reja dhe novatore, vlerësim nëse futja e një të drejte më të gjatë për bartjen e humbjeve do t'i ndihmonte ato të inovojnë, të marrin rreze dhe të rriten.			
			f) Zhvillim i një strategjie për të lehtësuar procedurat e administrimit tatimor për NVM, përmes anketave të biznesit.	Administrata tatimore nuk ka një strategji të posaçme për NVM, por mbështetet në planin e saj strategjik 2024-2028. Administrata tatimore ka publikuar në ëeb, në shtator 2025, rezultatet e anketës së fundit të kryer, nëpërmjet së cilës konfirmohet përmirësimi i performancës së administratës tatimore në perceptimin e tatimpaguesve. Ky studim nxjerr gjithashtu në pah progresin e bërë nga Administrata Tatimore, falë reformave të ndërmarra, që kanë për qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve tatimore, të komunikimit publik, forcimin e besimit të qytetarëve dhe bizneseve ndaj Administratës Tatimore dhe përmirësimin e klimës së biznesit. Nga ana e administratës tatimore, në prill 2023 është mundësuar transferimi i librave të shitjes dhe blerjes nga fiskalizimi në sistemin e-filing dhe, gjithashtu, në maj 2025 është kryer edhe parambushja e deklaratës së TVSH-së, me qëllim lehtësimin e procedurave për tatimpaguesit.	Drejtoria e përgjithshme e Tatimeve	2025
5	Sa. Shërbimet mbështetëse për NVM-të	Sa.1. BSS e ofruara nga qeveria Sa.2. Iniciativat e qeverisë për mbajtjen e BSS private	a) Përmirësimi i procedurave për aplikimin për shërbime mbështetëse të biznesit.	Analizë e barrierave administrative dhe kohore për përfitimin e programeve publike të mbështetjes së biznesit. (Hartim i udhëzuesve për aplikim)	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit	2026
				Akses i lehtë në informim mbi mundësitë e aplikimeve, info, trajnime, programe zhvillimi dhe ngritje kapacitetesh. (Pasurimi i website zyrtar dhe ëbsite-it "aksesi në financë" me informacione)	AIDA	2026
			b) Krijimi i një baze të dhënash on-line të trajnimit dhe mbështetjes ndaj NVM dhe punonjësve të tyre.	Suporti i NVM-ve vendase me mentorshipe, puntori dhe trajnime në kuadër të projekteve zbatuese në temat si digjitalizimi dhe ekonomia e gjelbër, qëndrueshmëria dhe inovacioni. (Ditë informuese, puntori, trajnime të personalizuar (1-to-1), aktivitetet rrjetëzimi/ SME Poëer Hours)	AIDA	2026
6	Sb. Prokurimi publik		a) Ndryshimi i disa dispozitave të Ligjit të Prokurimit Publik për të harmonizuar me standardet e BE-së.	Realizuar nga Agjencia e Prokurimit Publik		
			b) Monitorimi i pjesëmarrjes së NVM-ve në procedurat e prokurimit publik.	Realizuar nga Agjencia e Prokurimit Publik		
7	6. Akses në financë për NVM	6.1: Kuadri ligjor dhe rregullator 6.2: Financat bankare 6.3: Financat Jo-bankare 6.4: Venture capital 6.5: Lehtësirat Financiare	a) Forcimi i kapaciteteve për të garantuar letrat me vlerë të kreditorëve.			
			b) Rritja e skemave të mbështetjes financiare për NVM-të.	Grantet për NVM për vitin 2026 alokimi i fondit PBA 2026 (Programimi i fondeve për mbështetje për NVM)	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit/Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve	2026
				Skemë financiare për "Start-up dhe Inovatorë"	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit/Start up Albania	2026

				Hartimi i guidës për rrjetin e aksesit në financë për NVM (SMP) (realizuar) dhe organizimi i fushatave ndërgjegjëse dhe informuese për mundësitë e aksesit në financë nëpërmjet programeve të dedikuara të Bashkimit Evropian dhe gjithashtu organizimit të sesioneve teknike për aplikimin në thirrje specifike për programet ku Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit është eeligjshme	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit	2026
			d) Rritja e ndërgjegjësimi për instrumentet financiare jo bankare për të mbështetur përdorimin e tyre.	AIDA: Përmirësimi i platformës "Access to Finance" me funksionalitete të reja për filtrimin e instrumenteve financiare (bankare, jo-bankare, crowdfunding, grante, kapital sipërmarrës). Eëbsite aksesi ne finance)	Agencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve	2026
				Hartimi i guidës për rrjetin e aksesit në financë për NVM (SMP)	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit	2025
				Organizim i fushatave informuese për përdorimin e instrumenteve alternative të financimit për NVM-të.	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit	2026-2027
				Monitorimi i aksesit në finance për SME, shpërndarja sipas grupsoshave dhe gjinis. Monitorimi i kreditimit të Microfinances. - Rritja e aktiviteteve të leasing, factoring, lincësimi i kompanive fintech dhe Electronic Money Institutions dhe rritja e aktivitetit të tyre. - Transpozimi i direktivës evropiane PSD2	Banka e Shqipërisë	2025-2027
				Hartimi i FAS Survey Pilot për 2026 duke implementuar indikatorët e rinj për shpërndarjen, gjinore, grumoshes dhe vendndodhjes.	Banka e Shqipërisë	2026
				Mbledhja e informacioneve të detajuara për institucionet banka, jobanka dhe fintech.		
				Hartimi i ligjit për financim –Crowdfunding	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit Ministria e Financave	2026
				Ligji për byrë të kredive Credit Information Systems Development Project in the Eastern Balkans Vlerësimi i infrastrukturës së informacionit të kreditit në Shqipëri Hyrja në Zonen SEPA	Banka e Shqipërisë Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit Ministria e Financave	2026
			d) Përfundimi i shpejtë i Strategjisë për Edukimin Financiar dhe hartimi i një plani veprimi për zbatimin	Realizuar (Strategjia Kombëtare për Edukimin Financiar 2024-2026)		
8	7. Standardet dhe rregulloret teknike	7.1. Koordinimi i përgjithshëm dhe masat e përgjithshme 7.2. Harmonizimi me EU acquis 7.3. Aksesi i NVM në standardizim	a) Sigurimi i informacionit në një faqe të vetme dhe përmirësimi i ndërlidhjeve ndërmjet institucioneve.	Rritja e ofrimit të informacionit publik ndaj NVM-ve, në lidhje me kërkesat ligjore, standardet e sigurisë dhe informacione të tjera në lidhje me mbikëqyrjen e tregut.	Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut	2026
				Ofrimi i shërbimeve institucionale për NVM-të në mënyrë elektronike përmes faqes zyrtare	Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut	2026
				Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet DPS dhe AIDA ku linku i ëbsite-it të DPS të jetë tëkëdhënë i AIDA. DPS të japë informacion mbi cdo standard që mund t'i kërkojë nga AIDA/biznesi; AIDA të përshihet në listën e DPS me grupet e interesit për dërgimin cdo 3 muaj të Buletinëve Informativë të DPS.	Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit	2026
			b) Të zgjerohet fushëveprimi i marrëveshjeve shumëpalëshe të Bashkëpunimit Evropian për Akreditim.	Filimi i aktivitetit të ri të akreditimit për fushën e certifikimit të produktit -Aplikimi për tu bërë anëtarë e Agjencisë Europiane të Akreditimit (EA), përmes nënshkrimit të tre marrëveshjeve EA-MLA në fushat e laboratorëve kalibruar, laboratorët mjekësor dhe certifikim produkti -Mbaqja e statusit të marrëveshjeve pas nënshkrimit të tyre.	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit	2026-2028

				Rishikimi i paketës ligjore për metrologjinë me qëllim harmonizimin e plotë me acquis communautaire të BE-së.	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë	2026-2027
				Krijimi i një regjistri elektronik për instrumentet matëse në të gjithë territorin e vendit, statusin e tyre të verifikimit, subjektet e autorizuar për verifikim/inspektim, si dhe të dhëna relevante për palet e interesit si konsumatorë, institucione publike dhe operatorët ekonomikë.	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë	2026-2027
				Akreditimi i shërbimeve të kalibrit në fushat e matjeve të temperaturës, matësive elektrike, matjeve dimensionale, etj me qëllim ofrimin e gjurmueshmërisë metrologjike për NVM-të.	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë	2026-2027
				Pjesëmarrje në krahasime ndër-laboratorike rajonale (EURAMET) dhe ndërkombëtare (BIPM) për të validuar kompetencën teknike të laboratorëve të standardeve kombëtare të matjes.	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë	2026-2027
				Ratifikimi i Marrëveshjes së anëtarësimit të republikës së Shqipërisë në Konventën ndërkombëtare të Metrit (BIPM) në përmbyshje të objektivave institucionale dhe kriterëve teknike për institucionet metrologjike kombëtare.	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë	2026-2027
9	8a. Aftësitë e sipërmarrjes		a) Hartimi dhe zbatimi i një qasjeje gjithëpërfshirëse për inteligjencën e aftësive të NVM-ve.	Identifikimi përmes analizeve të nevojave për aftësi, i nevojave për fuqi punëtore dhe ligjit të aftësive të nevojave për përmbyshjen e funksioneve të sipërmarrjes.	Agencia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë	2026
			b) Jepni prioritet përpjekjeve për krijimin e komiteteve sektoriale të aftësive, siç përshkruhet në Strategjinë Kombëtare të Punësimin dhe Aftësive.	Dhënia e prioritetit për krijimin e Komiteteve sektoriale të aftësive, siç përshkruhet në Strategjinë Kombëtare të Punësimin dhe Aftësive, si një rrugë për të mbështetur kuptimin më të madh të nevojave për aftësi të tregut të punës dhe për të inkurajuar bashkëpunimin ndërmjet arsimit dhe biznesit. Krijimi i Komitetit të IV Sektorial në vitin 2026.	Agencia Kombëtare për Aftësimin Formimin, Profesional dhe Kualifikimet	2026
10	8b. Politikat e inovacionit për NVM-të	8b.1. Politikat për inovacionin 8b.2. Shërbimet mbështetëse institucionale të qeverisë për NVM-të inovative 8b.3. Shërbimet mbështetëse financiare të qeverisë për NVM-të inovative 8b.4. Bashkëpunimi i SME-ve dhe institucioneve kërkimore dhe transferimi i teknologjisë	a) Forcimi i mëtejshëm i mbledhjes së të dhënave për të mbështetur politikë bërjen e bazuar në dëshmi.	Krijimi i Regjistrit Kombëtar të Inovacionit të NVM-ve (Innovation Data Hub) (Zhvillim i bazës së të dhënave - Integrim me sistemet e AIDA dhe QKB).	MEI, AIDA, QKB	2027
			b) Rritja e mbështetjes financiare për të inkurajuar investimet në inovacion dhe kërkime.	Fondi Kombëtar për Inovacionin dhe Transformimin Teknologjik (Skenë grantesh dhe subvencionesh për start-up dhe SME që zhvillojnë produkte apo shërbime inovative).	MEI	2027
				Amendimi i ligjit për Start UP-et, Ligji Nr.25/2022 "Për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Start-up-ëve"	MEI	2026
			c) Vazhdoni vullnin për të krijuar një ekosistem të favorshëm për inovacion.	Krijimi i hapësirave inovative (Innovation Hub) për rritje kapaciteteve dhe testimin e teknologjive të aplikuara për SME. (Masa synon krijimin e një qendre inovacioni dixhital që mbështet NVM-të dhe start-up-et në transformimin e tyre digital, përmirëson aftësitë digjitale dhe nxit bashkëpunimin duke kontribuar në tranzicionin e Shqipërisë drejt një ekonomie më konkluruese dhe të bazuar në njohuri).	MEI	2027
				Integrimi i mjeteve të vetëvlerësimit të inovacionit (IRS Toolkit).	AIDA	2026
				Organizimi i "Green Innovation Labs" – punëtori praktikë që kombinon inovacionin digital dhe të gëlber për SME-të në sektorët e turizmit, agro-përpunimit dhe prodhimit.	AIDA	2026
				(Krijimi i modulit për "Green Innovation Lab" dhe implementimi i mjeteve të vetëvlerësimit IRS Toolkit).		

				Këshillim për zhvillimin e teknologjive të sigurta të inovacionit (p.sh. AI, big data, cloud), në përputhje me standardet e mbrojtjes së të dhënave.	IDP (Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale)	2026
				Udhëzim për përputhshmëri etike dhe ligjore të përdorimit të AI në SME, në kuadër të mbrojtjes së të dhënave	IDP (Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale)	2026
				Mbështetja e projekteve të teknologjisë dhe inovacionit që vijnë si bashkëpunim ndërmjet universiteteve dhe sektorit të biznesit/industrisë, me qëllim avancimin e proceseve teknologjike, inovacionit dhe zhvillimin e produkteve të reja. Hartimi dhe publikimi i thirrjeve për aplikime për projekte të teknologjisë dhe inovacionit. Organizimi i sesioneve informuese për aplikantët potencialë. Vlerësimi dhe përzgjedhja e projekteve fituese. Financimi i projekteve fituese	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit	2026-2027
11	9. NVM-të në një ekonomi të gjelbër	9.1: Kuartri i politikave mjedisore që synojnë NVM 9.2: Stimujt dhe instrumente për gjelbërimin e NVM	a) Zbatim dhe monitorim efektiv i masave të gjelbërimit të NVM-ve nëpërmjet koordinimit ndër sektorial. b) Rritja e mbështetjes financiare për gjelbërimin e NVM-ve.	Hartimi i taksonomisë së gjelbër kombetare në përputhje me standardet europiane. Rritja e Aksesit në Financa për NVM-të (sesione informuese dhe seminare trajnimi për të mundësuar rritjen e informimit, ndërgjegjësimin dhe aplikimet në projekte me fokus ekonomi në e gjelbër, duke përfshirë këtu dhe thirrjet për aplikime në kuadër të SMP)	Banka e Shqipërisë	2026-2027
				Rritja e Aksesit në Financa për NVM-të (sesione informuese dhe seminare trajnimi për të mundësuar rritjen e informimit, ndërgjegjësimin dhe aplikimet në projekte me fokus ekonomi në e gjelbër, duke përfshirë këtu dhe thirrjet për aplikime në kuadër të SMP)	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit	2026-2027
				Krijimi i një rregulloreje për strukturat akomoduese, agjencitë e udhëtimi dhe bizneset mbështetëse mbi standardet e qëndrueshmërisë dhe certifikimet mjedisore. (Përgatitje e një dokumenti orientues për sipërmarrjet, mbi incentivat që mund të përfitojnë për gjelbërim, burimet e financimit dhe mbështetjen publike).	Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit	2027
			c) Futje e instrumenteve rregullatore në përzierjen e politikave të gjelbërimit të NVM-ve	Hartimi i një udhëzuesi praktik për incentivat për gjelbërimin e NVM-ve (EU for Green)	Ministria e Mjedisit	2026
				Hartimi i Strategjisë afatmesme për financiat e gjelbra 2026-2029.	BSH	2026-2027
12	10. Ndërkombëtarizimi i NVM-ve	10.1: Promovimi i eksporteve 10.2: Integrimi i NVM-ve në zinxhirët globalë të vlerës 10.3: Promovimi i përdorimit të e-commerce	a) Krijimi i një mjedisi të favorshëm biznesi për digjitalizimin e NVM-ve dhe përvetësimin e tregtisë elektronike.	Hartimi dhe miratimi programit të eksportit 2030	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit	2026
				Platforma e eksportit dhe NEXTeen për gjetje partneritësh dhe shprehje interesi nga bizneset (CoI) AIDA : Rritja e B2B, pansire (planifikimi), misione biznesi dhe evente B2C	AIDA	2026
				Fushata digjitale promovuese për eksportet shqiptare për të rritur dukshmërinë ndërkombëtare të produkteve dhe shërbimeve vendase.	AIDA	2026-2027
				Rishikimi i planit të veprimit për e- commerce.	MEI	2026
				Hartimi dhe monitorimi i një programi vjetor eksporti për NMV të dedikuara dhe produkte/produkte të caktuara, në linjë me projektin e value chain të GIZ.	MEI	2026 - 2027

				Fushate ndërgjegjësimi për konsumatorin në lidhje me mbrojtjen e të dhënave në kuadër të platformave e-commerce.	IDP (Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale)	2026
			b) Sigurimi i zbatimit efektiv të Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve (2021-2027) në kontekstin e ndërkombëtarizimit të NVM-ve përmes monitorimit dhe vlerësimit të duhur.	Monitorimi dhe Rishikimi i Strategjisë BIDS ka përfunduar në shtator 2025, duke rishikuar vizionin e strategjisë për t'u përshtatur me procesin dhe objektivat në kuadër të integrimit evropian, duke vendosur në qendër edhe digjitalizimin e NMV-ve. Vizioni i ri synon një ekonomi shqiptare konkurruese, më të orientuar drejt inovacionit dhe të bazuar në njohuri, të integruar në Bashkimin Evropian dhe rajon, që krijon vende pune të reja e cilësore për gratë dhe burrat, duke shfrytëzuar potencialet e tranzicionit digjital dhe të gjelbër si dhe transformimet e sinqhrit ndërkombëtar të vlerës, duke theksuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe të barabartë. (realizuar)	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit	
				Hartimi i një programi trajnimi/mentorimi për sipërmarrjet e rinj eksportues, ku të përfshihet informimi mbi tregjet e jashtme dhe rregullat doganore	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit	2026
13	11. Transformimi digjital i NVM-ve			Rritja e ndërgjegjësimit dhe informimit të aktorëve në kuadër të thirrjeve për pjesëmarrje në projektet e transformimit digjital të hapura nga Komisioni Evropian nën Programin Digjital të Bashkimit Evropian (DEP), duke synuar rritjen e pjesëmarrjes së aktorëve shqiptarë në projekte transformuese që mbështesin digjitalizimin, inovacionin dhe adaptimin e teknologjive të reja. Masat përfshijnë informim të strukturuar, seminare orientuese, dhe asistencë teknike për aplikim.	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe AKSHI	2026-2027
				Në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025 – 2030: Promovimi i edukimit të NMV-ve në fushën e teknologjisë dhe sigurisë kibernetike	Autoriteti Kombëtar i Sigurisë Kibernetike (AKSK)	2026-2027
				Përgatitja e udhëzimeve mbi masat e sigurisë kibernetike të NMV-të	Autoriteti Kombëtar i Sigurisë Kibernetike (AKSK)	2026- 2027
				Organizimi i trajnimeve vjetore të dedikuara për punonjësit e NMV-ve	Autoriteti Kombëtar i Sigurisë Kibernetike (AKSK)	2026-2027
				Miratimi i Strategjisë Kombëtare të Intelligjencës Artificiale	AKSHI	2026
				Miratimi i Strategjisë Ndërsëktoriale "Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2027–2031", me afat realizimi tremujori i parë i vitit 2027.	AKSHI	Q1 2027